



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Teknik Imazherie”

Universiteti “Western Balkans University”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Altina XHAFFERI

Dr. Gjok TOSKU

Nëntor /2025

Tabela përmbledhëse e të dhënave të programit të studimit

Bachelor në “Teknik Imazherie”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Western Balkans University”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazheri
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Teknik Imazherie
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 439, datë 20.07.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike/6 simestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe / Gjuha Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 18 PAE / 5 PAK; 2023-2024 17 PAE / 13 PAK; 2024-2025 22 PAE / 10 PAK;
18	Numri i studentëve:	Va: 2022-2023 13 studentë; Va: 2023-2024 27 studentë; Va: 2024-2025 15 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Western Balkans ”/ Western Balkans University (WBU) është institucion jo publik i arsimit të lartë, hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave me VKM Nr. 679, datë 10.11.2021, me statusin Shkollë e Lartë Universitare. Struktura akademike e Universitetit “WBU”, aktualisht përbëhet nga tre njësi kryesore:

1. Fakulteti i Mjekësisë Dentare;
2. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;
3. Fakulteti i ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit;

Programi i studimit Bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi” është hapur me Urdhër të MASR Nr. 439, datë 20.07.2022, me formë studimi me kohë të plotë, 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike. Programi ofrohet nga Departmenti I Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazheri, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Në shqyrtim të aktivitetit të zhvilluar vitet e fundit, GVJ konstaton që PS Bachelor në “Teknik Imazherie” ka rezultate të prekshme në cilësinë e përgatitjes së studentëve duke u ngjizur atyre aftësi për të konkretizuar njohuri teknike imazherike në përgjithësi, aftësi për të vetvepruar në kuadrin e organizimit të kryerjes së punëve zbatuese në ambjentet spitalore, aftësi për të marrë përsipër përgjegjësi profesionale e etike, aftësi për të komunikuar në terma profesionalë, aftësi për të kërkuar zgjidhje duke u konsultuar me përvojën e kolegëve dhe literaturën profesionale, aftësi në menaxhimin e problematikave të ndryshme, njohjen e standarteve dhe metodologjive bashkëkohore. Në të gjitha takimet, por veçanërisht në takimin me studentët, GVJ mësoi që transmetimi i dijeve në kuadrin e këtij PS realizohet me synime të qarta që të diplomuarit e tij të jenë jo vetëm të kërkuar në tregun e punës vendas e të huaj por edhe të realizojnë ambicje të guximshme për të vazhduar studimet e thelluara në ciklet e studimeve Master e Doktoratë. Në përfundim të këtij aktiviteti GVJ konstatoi që PS Bachelor në “Teknik Imazherie” zhvillohet si një program i sukseshëm studimi, në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar, me një infrastrukturë mësimore që përmbush më së miri kërkesat e studentëve dhe mbështet në standardet bashkëkohore përpjekjet dhe arritjet e personelit në aktivitetin mësimor dhe punën kërkimore-shkencore me studentët. Vetë plani mësimor dhe programet e lëndëve janë profilizuar tashmë në ofertën e dijeve që i çon natyrshëm studentët si tek vazhdimi i cikleve më të larta të diplomimit ashtu edhe tek tregu i punës.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi” filloi me ngritjen e grupit të vlerësimit të jashtëm (GVJ). ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga WBU, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Dr. Altina Xhaferi, dhe Dr. Gjok Tosku. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatori teknik e ASCAL, Znj. Anilda Beqiraj.

Grupi u njoh dhe studjoi dosjen e vetvlerësimit duke u ndalur posaçërisht tek Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB). Njohja dhe studimi i dosjes çoi në formulimin e pyetjeve që lidhen me nevojën për qartësimin e gjetjeve në RVB, plotësimin e informacioneve, konkretizimin e paraqitjeve dhe saktësimin e vlerësimeve. Për të realizuar këto objektiva, GVJ u njoh më së pari me axhendën e vizitës në institucion. Vizita u realizua me datën 16.04. 2025. Gjatë vizitës, GVJ zhvilloi takime me Shefin e Departamentit të PS Bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi”, grupin e vetvlerësimit, stafin akademik, studentët, njësinë bazë të sigurimit të cilësisë, përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Planifikimit të Karrierës, sekretarisë mësimore. Gjithashtu GVJ vizitoi dhe mjediset mësimore, social kulturore e laboratorike ku zhvillohet programi i studimeve Bachelor në “Teknik Imazherie”. Në këto takime GVJ u njoh më nga afër me nivelin e plotësimit të standarteve të kërkuara në ofertën e programit, organizimin, drejtimin dhe administrimin e tij, mësimdhënien, mësimnxënien dhe ushtrimin e kompetencave, burimet financiare, infrastrukturën, logjistikën për realizimin e PS Bachelor në “Teknik Imazherie”, trajtimin e studentëve dhe gjithë mbështetjen për to si dhe punën që bëhej për sigurimin e cilësisë.

Mbështetur në dokumentacionin bazë të sistemuar në dosjen e vetvlerësimit, informacionet e marra, plotësimet, saktësimet si dhe gjetjet konkrete, GVJ formatoi gjithë bazën e nevojshme dhe të domosdoshme të të dhënave për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm (RVJ).

Universiteti WB është njohur me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm në datë 14.10.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr Prot 24/43, datë 14.10.2025. Institucioni njofton për komentet në ASCAL më datë 17.10.2025, nëpërmjet shkresës me Nr Prot 734/1. Institucioni nuk ka komente, Drafti kalon në raport final.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Teknik Imazherie”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësish kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti WBU synon mbështetjen e aspiratave arsimore dhe arritjet e të gjithëve, përgatitjen e specialistëve të lartë në fushën e mjekësisë, arritjen e standardeve më të larta akademike, promovimin e zhvillimit kërkimor-shkencor. Institucioni ofron program studimi që është në përputhje me interesat kombëtare dhe institucioneve politikëbërëse në fushën e mjekësisë. Referuar statutit, programet e studimit të ofruara nga WBU synojnë përgatitjen e profesionistëve në fushat respektive sipas programeve të studimit dhe janë në përputhje me misionin dhe objektivat e WBU. Këto programe jo vetëm që tentojnë të ruajnë vlerat akademike dhe kulturore kombëtare, por synojnë edhe zhvillimin dhe promovimin e mëtejshëm të tyre. <i>(Statuti i WBU evidence 1.1)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	WBU ofron programe në disa prej fushave kryesore shëndetësore duke synuar përgatitjen e specialistëve të shëndetit me qëllim ofrimin sa më cilësor të shërbimit ndaj pacientit dhe edukimin e tyre në vazhdim në përputhje me trendet e zhvillimit bashkëkohor. Programi Bsc në Teknik Imazherie ofron një mundësi formimi për studentët në fushën e imazherisë si pjesë e rëndësishme e kujdesit mjekësor. <i>(Statuti i WBU evdenca 1.1)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Referuar RVB-së Universiteti “WBU” ofron programe studimi që respektojnë gjithë kuadrin ligjor për arsimin e lartë dhe nuk bien ndesh me asnjë interes kombëtar. Studentët në WBU jo vetëm që marrin vlera të shtuara profesionale por edukohen me ndjenjën e humanitetit dhe vlerësimin e interesit kombëtar. Programi i studimit ofrohet në përputhje me interesat kombëtare dhe ato të institucioneve politikëbërëse në fushën e mjekësisë” si dhe gjetjeve të tij gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që Programi i studimit Bachelor në “Teknik Imazherie” ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillimin e institucionit.

	GVJ i konsultoi paraprakisht dokumentet bazë mbi të cilët zhvillohet aktiviteti i Universitetit "WBU" dhe konstatoi sipas <i>(nenit 3 të statutit)</i> përcaktohet qartë që programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me rregulloren e Universitetit. Në mënyrë të veçantë programet e studimit të ciklit të parë hartohen dhe ofrohen në përputhje me Statutin e Universitetit. Zbatimi i përcaktimeve statutore dhe rregullores së institucionit konstatohet edhe në standartizmin e mënyrës së hartimit të dokumentacionit si të njësisë kryesore ashtu edhe të njësisë bazë.
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	WBU është institucion i ri, i sapo formuar dhe është në hapat e para të formimit të përvojës së tij në drejtim të mënyrës së organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti I Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazheri, i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike. Sipas evidencës <i>(Tabelat RVB Ba ne TI, tabela nr.4.1)</i>, ky Fakultet për vitin akademik 2024-2025 ka gjithsej 65 pedagogë, nga të cilët 43 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: - 1 ka titullin "Profesor" - 2 kanë titullin "Profesorë të Asociuar"; - 17 kanë gradën Doktor Shkencash; - 23 Asistent Lektorë me Msc; 22 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku: - 2 kanë gradën Doktor Shkencash; - 20 Asistent Lektorë me Msc; Ndërsa Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri ka 13 PAE nga të cilët 5 me gradën shkencore Doktor dhe 8 me Master Shkencor Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit në këtë vit akademik (2023- 2024) sipas evidencës <i>(Tabelat RVB Ba ne TIR, tabela nr.4.2)</i>, rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie 32 pedagogë gjithsej, ku 21 PAE, nga të cilët: - 2 Prof.Asoc; - 12 me titullin akademik Dr; - 7 asistente-lektore me Msc; 10 PAK nga të cilët: - 2 me gradën Doktor Shkencash; - 8 asistente-lektore me Msc;

	Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2024-2025 si numër fizik rezulton 70% me 30%. Pedagoget efektiv PAE mbulojnë rreth 3000 ore në auditor, e cila përkon me rreth 88% të ngarkesës totale mesimore. (Tabelat RVB Baze në TI, tabela nr.4.3) Në vlerësimin e të dhënave për vitin akademik 2024-2025, GVJ mbështetur në dokumentacion dhe në vizitën në IAL konstatoi që Njësia bazë ka kapacitetet, përvojën dhe burimet e nevojshme në fushën akademike për të ofruar programin e studimit.			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	WBU është institucion jo publik në Republikën e Shqipërisë i orientuar kryesisht në ofrimin e programeve të studimit në fushën e mjekësisë ose të ngjashme me të. Bazuar në statutin e institucionit, Rregulloren e universitetit, Rregulloret e fakulteteve, strategjinë e zhvillimit dhe programet që çdo fakultet ofron, fusha e përgjithshme dhe specifike e programeve të studimit është në përputhje me fushën kryesore të WBU. Programi i studimit Bachelor në Teknik Imazherie, është në të njëjtin profil që ka njësia kryesore. Institucioni zbaton me përpikmëri çdo udhëzim apo akt nënligjor të publikuar. (Statuti i WBU evidence 1.1) (Rregullore e Universitetit WBU evidence 1.2) (Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore teknike evidence 1.3) (Rregullore e programit të studimit TI evidence 1.3)			
Konkluzione	GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që : - WBU ofron programe studimi në përputhje me interesat kombëtare dhe synon të ruajë vlerat akademike kulturore kombëtare; - Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, që është të krijojë, zhvillojë dhe përcjellë dije përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të formojë specialist të lartë në fushën e mjekësisë dhe shërbimit shëndetësor në përgjithësi; - UA ka kapacitete intelektuale me personel akademik të kualifikuar dhe me përvojë infrastrukturore për të realizuar aktivitetet edukative dhe kërkimore shkencore;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi RVB si dhe mori informacione plotësuese gjatë vizitës në institucion. GVJ konstaton që Universiteti "Western Balkans" ka marrëdhënie të mbështetura në akte ligjore e nënligjore me të gjitha njësitë kryesore e ato bazë brenda institucionit duke siguruar një bashkëpunim funksionues. Njësitë bazë të këtij institucioni, ndër to edhe Departamenti i Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazheri, organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore shkencore në koordinim të plotë me njësitë kryesore. Bashkëpunimi është i njehsueshëm në aktivitetet e promovimit të institucionit, në koordinimin e trajnimeve, objektivat për rritjen e cilësisë së botimeve shkencore si dhe në përdorimin e ambienteve të përbashkëta. GVJ konstaton që ky bashkëpunim është i qëndrueshëm dhe efikas. (<i>Statuti i WBU evidence 1.1</i>)
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Përveç gjetjeve në RVB lidhur me bashkëpunimin e institucionit me institucione homologe brenda e jashtë vendit si dhe shërbimet mjekësore vendës e të huaj në realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, GVJ u informua konkretisht edhe gjatë takimit me përfaqësuesit e Zyrës së Projekteve e Marrdhënieve Ndërkombëtare ku mësoi se kjo zyrë ka funksion koordinues për projektet duke u fokusuar si në projektet e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme. Referuar dokumentit (<i>Marrevshjet evidneca 1.9</i>) Universiteti WBU ka nënshkruar një sërë marrëveshje në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike,	Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi që Universiteti WBU ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit përmes Koordinatorit të Studentëve. Akoma nuk ka përfunduar cikli i parë i studimeve në degën e Teknik Imazherie dhe radioterapi, dhe eksperiencia është akoma e pa konkretizuar por vetë departamenti ishte aktiv në mbështetjen e marrëdhënieve me qendrat spitalore/punëdhënësit përmes marrëveshjeve të ndërsjella dhe organizimeve të përbashkëta.

praktikave të punës apo stazhit etj.	(Marrëveshjet e bashkëpunimit evidence 1.9)			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Referuar RVB cdo vit akademik, institucioni dhe njësitë bazë kryejnë analizën e punës dhe rezultatet e bashkëpunimit një pjesë e të cilave janë bërë publike në raportet vjetore të fakultetit dhe universitetit. UAL dhe partnerët janë përpjekur të harmonizojnë bashkëpunimin e tyre me situatën e re të krijuar. Marrëveshjet e realizuara me institucionet shëndetësore apo akademike kanë impact pozitiv. Vihet re rritje e numrit të studentëve të regjistruar në këtë program vit pas viti. (Marrëveshjet e bashkëpunimit evidence 1.9) (Vizita në sekretari)			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit. Rregulloret e Institucionit, njësisë kryesore dhe të organeve të tjera rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet strukturave brenda institucionit; - Institucioni realizon marrëveshje bashkëpunimi me institucione spitalore dhe palë të treta në funksion të realizimit të programit të studimit; - Nëpërmjet marrëveshjeve institucioni është më pranë tregut të punës, kërkesave të tregut të punës dhe do të mundësojë realizimin e praktikave mësimore;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në Teknik Imazherie është i strukturuar në 3 vite akademike, organizuar në 6 semestra. Zhvillohen gjithsej 44 modulet përkatëse të ndara sipas 3 viteve shkollore (16 në vitin e parë; 14 lëndë/module në vitin e dytë; dhe 14 lëndë/module në vitin e tretë). Në këto lëndë në planin mësimor përfshihet edhe punimi i diplomës ose provimi final, si edhe praktika verore. Lëndë të detyrueshme janë 42, dhe lëndë me zgjedhje janë 2. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Duke iu referuar kurrikulës së programit të studimit dhe rregullores vërehet që programi i studimit Bachelor në Teknik Imazherie është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Një semestër i rregullt përmban 30 ECTS. Bazuar në Rregulloren e organizimi të programit të studimit, kreditet ECTS të çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përlllogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit. <i>(Plani mesimor Ba ne TI evidence 2.3.)</i> <i>(Rregullore e programit te studimit TI evidence 1.3)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të	Bazuar në planin mësimor, si edhe në programet e lëndëve mund të arrihet në përfundimin se programi i studimit Bachelor në Teknik Imazheri dhe Radioterapi siguron formimin e shprehive të veçanta në fushën e teknikave Radiologjike. Objektivat e programit janë përshtatur me evoluimin e shkencave në imazheri. Programi i studimit i aftëson studentët të zhvillojnë kompetenca të imazherisë dhe radioterapisë, etikës profesionale etj. Të diplomuarit gjithashtu fitojnë kompetencat e nevojshme për të vazhduar karrierën e tyre akademike. <i>(Plani mesimor Ba ne TI evidence 2.3)</i> <i>(Syllabuset Ba ne TI .)</i>

nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Në VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë” ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021 në tabelën nr 1 në Shtojcë janë përcaktuar elementët e programeve të studimit. Për ciklin e parë të studimit, në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm për përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme dhe duhet të ketë 15 – 20% të krediteve; në kategorinë B, përfshihen disiplina të formimit karakterizues të programit për përgatitje shkencore dhe duhet të kenë 50 – 55% të krediteve; në kategorinë C përfshihen lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup lëndësh me zgjedhje dhe duhet të kenë 12 – 15% të krediteve. Ndërsa në kategorinë D përfshihen lëndët plotësuese si gjuhë të huaja, njohuri informatike dhe praktika profesionale dhe duhet të ketë 10-15%% të krediteve totale në programet e studimit bachelor. Ndërsa në kategorinë E janë detyrimet përmbyllëse për diplomim dhe duhet të ketë 3 – 5% të krediteve. Përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jenë më pak se 70% në nivelin Bsc. Në planin mësimor të programit të studimit bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi” lëndët jepen në kredite dhe të grupuara sipas veprimtarisë formuese në përputhje me legjislacionin në fuqi si vijon: ▪ kategoria A - - - $35/180 = 19\%$; ▪ kategoria B - - - $95/180 = 52.8\%$; ▪ kategoria C - - - $24/180 = 13.3\%$; ▪ kategoria D - - - $20/180 = 11\%$; ▪ kategoria E - - - $6/180 = 3.3 \%$; Bazuar në (VKM 879, datë 18.12.2019) shpërndarja e lëndëve është përgjithësisht e rregullt dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi. <i>(Plani mesimor Ba ne TI evidence 2.3.)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës	Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) programi i studimit ka përcaktuar ngarkesën në kredite të praktikave klinike si dhe të detyrimeve përmblendhëse. Përkatësisht janë përcaktuar 4.5 kredite praktikë

profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.	profesionale në vitin e parë akademik akademik (përfshirë këtu dhe praktikat lëndore), 10.5 kredite praktike në vitin e dytë akademik (përfshirë këtu dhe praktikat lëndore) dhe 13 kredite në vitin e tretë akademik (përfshirë këtu dhe praktikat lëndore) Në total janë 28 kredite praktika profesionale për këtë program studimi. Ky program studimi ka përcaktuar detyrimet përmbledhës me 6 kredite për mbrojtjen e diplomës. <i>(Plani mesimor Ba ne TI.evidence154)</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Universiteti WBU është institucion jo publik i cili organizon dhe ushtron veprimtarinë e tij mbështetur në ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi për arsimin e lartë. <i>(Statusi i IAL evidence 1.1, Strategjia e WBU evidence1.6)</i>
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Referuar RVB-së, si dhe planit mësimor, programi i studimit Bachelor në Teknik Imazherie ka të njëjtën emërtesë dhe pothuaj përmbajtje të ngjashme të lëndëve në këtë nivel me programe të njëjta të së njëjtës fushë. Hartimi i programit është mbështetur dhe në disa programe të ngjashme europiane. <i>(Raporti I vlerësimit të brendshëm)</i>
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Në sistemin e brendshëm të sekretarisë ka një kodifikim të programeve të studimit si dhe të lëndëve /moduleve përkatëse të këtij programi si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën angleze. <i>(Plani mësimor I PS evidence 2.3, vizita në sekretari)</i>
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të	Programi i studimit bachelor në "Teknik Imazherie" ofrohet nga Departamenti i Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazheri, i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, WBU.

përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky program studimi nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë vendas apo të huaj.			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se:</i> - Programi i studimit është i organizuara në lëndë e module. Në planin mësimor lëndët janë paraqitur të ndara sipas tipit të veprimtarisë, në lëndë bazë, karakterizuese, lëndë ndërdisiplimore, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, në përputhje me VKM nr. 41 datë 24. 01.2018 ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021; - Lëndët në programin e studimit kanë të përcaktuar ngarkesën në kredite ECTS; - Programi i studimit është mbështetur në disa programe të ngjashme europiane;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Programi i studimit ofrohet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri”, dhe VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë” ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike përbëhet nga këto njësi bazë: 1. Departamenti i Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazherisë; 2. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; 3. Departamenti i Mjekësisë 4. Departamenti i Kirurgjisë 5. Qendra Kërkimore Shkencore për Kërkimin e Semundjeve të Rralla

	Në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, janë të angazhuar personel akademik efektiv dhe me kontratë, ku për dy vite akademike të dhënat janë si vijon: <table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr./PhD.</td><td>3</td><td>2</td><td>5</td><td>3</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>5</td><td>4</td><td>8</td><td>7</td></tr><tr><td>Totali</td><td>8</td><td>8</td><td>13</td><td>11</td></tr></table> Çdo njësi bazë është i përbërë nga të paktën 7 staf akademik, ku të paktën 3 prej tyre janë me gradë shkencore. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, Departamenti i Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazheri, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike: <i>(Tabelat RVB Ba ne TI, tabela nr.2.5)</i>	Kualifikimi i stafit	2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	-	-	-	-	Prof. Asoc.	-	2	-	1	Dr./PhD.	3	2	5	3	Msc.	5	4	8	7	Totali	8	8	13	11
Kualifikimi i stafit	2023-2024		2024-2025																																
	PAE	PAK	PAE	PAK																															
Prof.Dr.	-	-	-	-																															
Prof. Asoc.	-	2	-	1																															
Dr./PhD.	3	2	5	3																															
Msc.	5	4	8	7																															
Totali	8	8	13	11																															
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Departamenti i Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazheri ka angazhuar 1 personel ndihmës akademik por edhe personel teknik radiolog të cilët relizojnë ndjekjen e praktikave profesionale si në laboratorët e WBU ashtu edhe në kabinetet e ndryshme të imazherisë dhe radioterapisë në përputhje me marrëveshjet e bashkëpunimit. <i>(Marrëveshjet e bashkëpunimit evidenca nr 1.9., Tabela RVB Ba ne TI,)</i>																																		
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ka angazhuar një coordinator i cili është përgjegjës për programin e studimit dhe angazhohet në ndërtimin e orarit të çdo semestri, në orientimin e studentëve, bën informimin mbi rregulloren e PS, monitoron procesin mësimor si dhe adreson problematikat e ndryshme që lindin gjatë procesit mësimor.																																		

të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	(Rregullore e programit të studimit evidenca 1.3)			
Konkluzione	GVJ konstaton se Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe Departamenti i Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazheri përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore dhe caktimin e koordinatorit të programit. Departamenti ka përzgjedhur kordinatoin e programit të studimit, i cili ka rol kyç në sigurimin e cilësisë së programit të studimit dhe siguron garantimin e suksesit të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Referuar dosjes së vetëvlerësimit, vizitës në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazheri dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike zotërojnë informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në Teknik Imazherie. Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim që nga plani strategjik i programit të studimit, statuti i universitetit, rregullorja e universitetit, rregullorja e fakultetit, rregullorja e diplomimit e deri tek rregulloret e sekretarisë dhe zyrës së burimeve njerëzore. Informacionet janë të publikuara në faqen e internetit të Universitetit dhe të aksesueshme nga të gjithë. (Plani mësimor evidence 2.3, rregullorja e programit evidence 1.3; syllabusët e lëndëve; CV e personelit evidence 6.23)

	<i>(Statuti i WBU evidence I.1); (Rregullore e FSHMT evidence 1.3)</i> <i>(Rregullore e Burimeve njerezore evidence 4.13)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Referuar planit mësimor të PS, konstatohet se plani mësimor është i organizuar në lëndë dhe aktivitete formuese në përputhje me VKM 41, dt.24.01.2018. Programi i studimit “Teknik imazherie” është organizuar në tre vite akademike me 6 semestra. Zhvillohen gjithsej 44 lëndë të ndara sipas 3 viteve shkollore (16 lëndë në vitin e parë; 14 lëndë në vitin e dytë; 14 lëndë në vitin e tretë). Në 44 lëndët që parashikohen në planin mësimor përfshihen edhe punimi i diplomës ose provimi final, si edhe praktika verore. Lëndë të detyrueshme janë 42. Lëndë me zgjedhje janë 4. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje: - Kategoria A (lëndët e formimit të përgjithshëm /bazë): 35 ECTS (19%) - Kategoria B (lëndë të formimit karakterizues): 95 ECTS (53%) - Kategoria C (lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje): 24 ECTS (13%) - Kategoria D (lëndë plotësuese dhe praktika profesionale): 20 ECTS (11 %) - Kategoria E (detyrimet përmbyllëse/mbrojtja e temës së diplomës): 6 ECTS (3%) Programi i studimit Bachelor në Teknik Imazherie është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. <i>(Plani mësimor i Bachelor në Teknik imazherie evidence 2.3)</i> <i>(Tabelat RVB Ba ne TI, tabela nr.2.3)</i>

Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit në TI përmban gjithë informacionet nevojshme në lidhje me kriteret e pranimit në PS, metodologjinë e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. <i>Neni 66 i rregullores së UA, parashikon transferimin dhe ekuivalentimin. UA pranon transferime dhe ekuivalente studimesh nga universitete të tjera në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe statutin e universitetit.</i> <i>(Rregullore e PS evidence 1.3, Rregullore e FSHMT evidence 1.4; Rregullore WBU evidence 1.1;)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Nga shqyrtimi i Planit mësimor të programit të studimit, GVJ konstatoi se në planin mësimor të programit janë të pasqyruara informacionet lidhur me ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit. Në rregulloren e programit si dhe në syllabuset e lëndëve, paraqitet informacion i hollësishëm për frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, etj. Konkretisht në përgjithësi mënyra e vlerësimit të lëndës është si më poshtë: Provimi i ndërmjetëm zë një përqindje 25-30 % Aktivizimi në orët mësimore- 10 % Detyrat e kursit, projektet, laboratoët deri në 15% Provimi përfundimtar – 55- 60 % <i>(Plani mësimor i Bachelor në Teknik imazherie evidence 2.3)</i> <i>(Syllabuset e lendeve)</i> <i>(Tabelat RVB Ba ne TI)</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Refruar RVB dhe takimeve në institucion dokumentacioni i programit mësimor është në përditësim të vazhdueshëm dhe në çdo fillim viti akademik dorëzohet sipas formateve të aprovuara dhe të miratura në Senatin akademik dhe arkivohet në departament. Programi i studimit ka pasur ndryshime të pakta përgjatë këtyre viteve pasi edhe nuk është mbyllur akoma një cikël i plotë studimi. Megjithatë përpjekjet e stafit akademik për përmirësimin e syllabuseve vit pas viti kërkohet punë me kompetencë edhe për përmirësimin e programit studimor. <i>(Programi i studimit evidence 2.3)</i>

Konkluzione	GVJ konstaton se: - plani mësimor është i ndërtuar bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) me ndarjen e kategorive, përshkrimin e detajuar të syllabusit, ndarjen e praktikave dhe të gjithë komponentëve të tjerë; - Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike në lidhje me kreditet dhe dokumentacionin e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve; - Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit është i hartuar me lëndë të cilat janë esenciale për marrjen e njohurive në fushën e imazherisë dhe radioterapisë. Emërtimi i programit të studimit tregon kompetencat që përfitojnë studentët që diplomohen në këtë program studimi. Emërtimi i lëndëve është në përshtatje me përmbajtjen e tyre dhe janë të njëjta me lëndë të ngjashme që zhvillohen në programe të tjera studimi të ngjashme nga fusha e studimit. Emërtimet e moduleve/lëndëve, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikat profesionale mundësojnë njohuri, aftësim për punë të studentëve. Në vitin e parë zhvillohen kryesisht lëndë bazë të formimit të përgjithshëm ndërsa në dy vitet e tjera akademike programi i studimit parashikon zhvillimin e lëndëve me formim specifik profesional duke ndihmuar kështu në rritjen e kompetencave të studentëve. (Plani mesimor Ba ne TI evidence 2.3)




Kriteri 2.Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Programi ofron mundësi të shumta informacioni si dhe nocione bazë dhe të thelluara profesionale. Pas përfitimit të njohurive bazë studenti zhvillon në mënyrë të vazhdueshme lëndë të formimit të thelluar profesional duke përfshirë këtu elementët e studimit që nga Radiologjia konvencionale dhe duke vazhduar drejt lëndëve të cilat merren me radiologjinë e avancuar si CT, MRI, Mjeksësi nukleare. Po ashtu studenti merr njohuri të plota edhe për Lëndën e radioterapisë si element i rëndësishëm i ofrimit të kujdesit shëndetësor. Të gjitha këto njohuri i japin studentit aftësinë e nevojshme profesionale për ofrimin e shërbimit të tij në institucionet e ndryshme shëndetësore si dhe në kabinetet e radiologjisë në çdo qendër shëndetësore që i zotëron ato. Nga sa më sipër rezulton se lëndët, shpërndarja e tyre në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional. <i>(Plani mesimor Ba ne TI evidence 2.3)</i> <i>(Syllabuset e lendeve evidence 2.10)</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori – praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. <i>(Programi i studimit BA në teknik imazherie evidence 2.3)</i> <i>(Syllabuset e lendeve)</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Teknik Imazheri parashikon lëndë themelore, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve. Bazuar në lëndën specifike, programi paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësimnxënies praktike. Për më tepër, programi i studimit ka përfshirë në kurrikulën e tij mundësi praktike në terren. Studentët duhet të fitojnë dhe përmirësojnë njohuri praktike në tema të ndryshme imazherike që mund të hasin gjatë periudhës së praktikës në një institucion shëndetësor. Pjesëmarrja e studentëve në praktika të organizuara nga Universiteti, në bashkëpunim me institucione që ofrojnë shërbime imazherike,

	lehtëson punësimin e studentëve në fund të programit të studimit. <i>(Programi i studimit BA në Teknik Imazherie evidence 2.3)</i> <i>(Marreveshjet e bashkepunimit per praktikat profesionale evidence 1.9)</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Syllabuset e lëndëve përditësohen në mënyrë të vazhduar por jo detyrimisht me literaturë të 5 viteve të fundit. Literatura në gjuhën shqipe dhe angleze e këtij programi ka problemet e veta në mungesën e teksteve në gjuhën shqipe. Pjesa më e madhe e literaturës referuese është në gjuhë të huaj. <i>(Syllabuset e lëndëve evidence 2.10)</i> <i>(Lista e literaturës në biblioteke evidence 4.32 4.33)</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Imazheri dhe radioterapi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave. Si përfundim synohet që studenti të përvetësojë njohuri shkencore, aftësi praktike dhe menaxheriale. <i>(Syllabuset e lëndëve)</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Teknik Imazherie dhe radioterapi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master. Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë te studentët një bazë shumë të mirë shkencore për vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. <i>(Programi i studimit bachelor evidence 2.3)</i> <i>(Syllabuset e lëndëve evidence 2.10)</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin

	e kualifikimit, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës; - programi i studimit zhvillohet në tre vite akademike dhe ka një ngarkesë totale kreditesh Europiane prej 180 ECTS. Cdo vit akademik ka 60 kredite ECTS; - GVJ vlerëson se ky program studimi me lëndët në përbërje të tij, mënyra e zhvillimit të programit dhe format e kontrollit të njohurive garanton përfshimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Teknik Imazherie dhe radioterapi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master. Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë te studentët një bazë shumë të mirë shkencore për vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. Departamenti i Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazheri, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, është vazhdimisht në marrëdhënie me partnerët shëndetësor dhe tregun në përgjithësi, me qëllim evidentimin dhe inserimin në programet e lëndëve të nevojave dhe kërkesave të tregut. (Programi i studimit bachelor evidence 2.3) (Syllabuset e lëndëve)
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e	Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit

tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	të studimit. Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, duke vlerësuar karakteristika që lidhen me aftësitë komunikuese dhe profesionale të pedagogut, etikën, metodat inovative të përdorura, korrektesën, vlerësimet e dijeve të studentit etj. Ky pyetësor zhvillohet në fund të çdo semestri. Studentët janë të angazhuar në senat akademik, në NjSBC dhe në disa komisione të tjera në përputhje me aktet ligjore dhe për pasojë janë zë I studentëve dhe pjesë e vendimarrjes. <i>(Takimi në WBU, rregullore e WBU evidence 1.2)</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Referuar RVB-së si dhe takimeve në Instiucion, Fakulteti i Shkencave mjekësore Teknike mban kontakte me Urdhrin e Infermierit, FSHMT në UMT si dhe disa shoqata europiane me qëllim përditësimin e syllabuseve të disa moduleve si dhe për integrimin e të rejave të fundit në fushën e radiologjisë në përgjithësi. <i>(Marrëveshjet e bashkëpunimit evidence 1.9, Raporti vjetor institucional evidence 1.16, 4.38)</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - WBU ka përfshirje të studentëve në disa komisione në mbështetje të akteve ligjore si dhe bashkëpunon me institucione universitare apo organizata të ndryshme me qëllim përmirësimin dhe integrimin e risive në programin e studimit; - Departamenti ka prioritet përmirësimin dhe përditësimin e kurrikulave në shërbim të njohurive të nevojshme për përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------




				X
--	--	--	--	---

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Universiteti WBU përdor forma të ndryshme mësimdhënie që përfshijnë leksionet, seminarët, detyrët e kursit, projektet, laboratorët etj. Vihet re ndërthurje e teorisë me praktikën apo laboratorët në pjesën më të madhe të moduleve dhe lëndëve të këtij programi studimi. Universiteti WBU në përgjithësi si dhe FSHMT në veçanti ofrojnë infrastrukturën e plotë për realizimin e laboratorëve mësimorë, për realizimin e projekteve në grup të studentëve etj. <i>(Programi i studimit evidence 2.3, Vizita e GVJ)</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Gjatë vizitës së GVJ në WBU stafi akademik pjesmarrës konfirmoi shumëllojshmërinë e shpërndarjes së informacionit. Leksionet jepeshin tek studentët në forma të ndryshme duke filluar nga paraqitja kompjuterike në klasë, shkarkimi i këtyre materialeve në version elektronik, video etj. Personeli akademik përdor metoda të ndryshme mësimdhënie duke i alteruar ato në varësi të modulit, temave apo kërkesës së studentëve. Format e metodat e mësimdhënies ju bëhen të ditura studentëve me anë të syllabusve. Në syllabuse pasqyrohen larmia e metodologjisë së përdorur si leksionet me anë të të cilave studentët marrin njohuri teorike të cilat i vënë në praktikë apo krahasojnë praktikën në lidhje me to në orët e diskutimeve dhe detyrave të kursit. <i>(Programi i studimit evidence 2.3, Vizita e GVJ)</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Personeli akademik konfirmoi mbështetjen e plotë nga institucioni në përmirësimin e aftësive didaktike të tyre. Institucioni ofron për stafin sistemin elektronik për mësimdhënie, laboratorët apo kabinetet të ngjashme për rritjen e aftësive didaktike të personelit. Gjithashtu WBA nxit personelin akademik në përmirësimin e aftësive didaktike me

	anë të projekteve Erasmus + apo projekte të tjera bashkëpunimi me Universitete partne europiane. <i>(Vizita GVJ, Të dhënat mbi mobilitetin evidence 3.1, 3.2)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie zotëron kualifikimin e duhur akademik për mësimdhënie dhe për kryerje të veprimtarive të tjera mësimore në lëndët e këtij programi. Në këtë program, vihet re angazhimi si ndihmes akademik dhe udhëheqës të praktikave profesionale i një numri të shtuar të personave të diplomuar në degën Teknik Imazherie si element komplementar në mesimdhënien teorike të studenteve të këtij programi studimi. Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit), si dhe takimit me stafin akademik, u konstatua se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Teknik Imazherie” zotëron kualifikimin e duhur akademik, në nivelin e kërkuar për mësimdhënie dhe kryerje të veprimtarive të tjera mësimore në lëndët e programit në fjalë.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Njësia kryesore vlerëson format e mësimdhënies në mënyrë të vazhdueshme. Studentët shprehen se shumë prej sygjerimeve të tyre janë marrë në konsideratë gjatë procesit të mësimdhënies. Studentët janë aktivë në dhënien e opinionit të tyre jo vetëm nëpërmjet diskutimeve por edhe nëpërmjet pyetësorëve që plotësojnë studentët ku japin vlerësimin dhe mendimin e tyre mbi lëndët dhe format e metodat e mësimdhënies. Njësia kryesore realizon pyetësorë të përvitshëm të fokusuar në metodologjinë e mësimdhënies. <i>(Takimi i GVJ, pyetësori i studentëve evidence 6.1, 6.2)</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit	Institucioni realizon leksione të hapura, fton lektorë të huaj, bën trajnime për stafin akademik etj të gjitha këto me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies. Lektorët e rinj janë të angazhuar në implementimin e metodave inovatore, leksioneve të alternatura me laboratorë apo praktika etj. Gjithashtu WBU është munduar të përfshijë grup moshë të ndryshme të stafit akademik për të nxitur dhe ndërthurjen e metodave tradicionale me ato inovative të mësimdhënies.

të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	(Tabela BA për TI, RVB)			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Forma e mësimdhënies në këtë program studimi është ndërthurje formave të mësimdhënies si leksion, diskutime në auditor, detyrë kursi/ese, praktikë profesionale, etj, larmia e metodologjisë së përdorur pasqyrohet në syllabuse; - WBU garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se institucioni sanksion mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale në rregullore. Universiteti informon studentët për të gjitha rregulloret, proceset, politikat dhe mekanizmat që udhëheqin studimet e tyre. Këto rregullore janë të publikuara eshë në faqen e Internetit të Universitetit. Rregullorja e insitucionit parashikon në mënyrë të qartë modalitetet e vlerësimit. Procesi i vlerësimit është një shumatore e vlerësimit të vazhdueshëm dhe atij përfundimtar. WBU ka hartuar dhe miratuar rregulloren e posaçme për mësimdhënien dhe testimin e

	njohurive. Komunikimi i rregulloreve nëpërmjet platformës online siguron informimin e plotë të studentëve. <i>(Syllabyset e lendes evidence 2.10)</i> <i>(programi i studimit evidence 2.3)</i> <i>(Rregullore provimesh evidence 3.28, 3.30)</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga takimi me studentët dhe me stafin akademik, gjatë vizitës në institucion, rezultoi se stafi akademik, në javën e parë të semestrit, informon studentët mbi programin lëndor, i cili përmban informacion mbi: përmbajtjen e lëndës të organizuar në javë, objektivat e lëndës, rezultatet e të nxënës të lëndës, librin shkollor dhe materialet e tjera të lëndës, metodën e vlerësimit të lëndës, shpërndarjen e ngarkesës etj. Syllabuset e lendeve janë të publikuara në ndërfaqet e secilit kurs. <i>(Syllabuset e Lëndëve të PS evidence 2.10)</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi i njohurive të studentit bëhet në mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Përgjatë zhvillimit të lëndës bëhen seminare, miniteste projekte, për vlerësimin e njohurive të studentit. Këto janë përshtatur në varësi të strukturës së modulit. <i>(Programi i studimit evidence 2.3)</i> <i>(Rregullore e fakulteti evidence 1.4)</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Njësia bazë, departamenti dhe personeli akademik përgjegjës për programin e studimit ka prioritet përditësimin dhe përmirësimin e formave të mësimdhënies. WBU dhe FSHMT aplikon praktikën e realizimit të pyetsorëve të përvitshëm për stafin dhe studentët me qëllim vlerësimin dhe përmirësimin e procesit të mësimdhënies. Po ashtu koordinatori i programit të studimit është në kontakt të vazhdueshëm me studentët dhe stafin akademik me qëllim reflektimin e problematikave të studentëve në stafin akademik. <i>(Pyetsori i studentëve evidence 6.2)</i> <i>(Rregullore e FSHMT evidence 1.4)</i>
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të	UA mundëson përdorimin dhe alternimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies në përputhje me rezultatet e prishme të syllabuseve të ndryshme.

shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Ata nxisin dhe autonominë e studentit nëpërmjet laboratorëve, praktikave apo projekteve të caktuara në grup apo individualisht. Për vetë specifikën e disa moduleve, bashkëpunimi lector – student është më i ngushtë duke i bërë studentët më konfident dhe më kërkuar. <i>(Syllabuset e lendeve evidence 2.10)</i> <i>(Programi i studimit evidence 2.3)</i> <i>(Vizita në institucion)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - Për vlerësimin e njohurive përdoren forma të ndryshme kontrolli që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar; - Departamenti dhe personeli akademik përgjegjës për programin e studimit ka prioritet përditësimin dhe përmirësimin e formave të mësimdhënies, në këtë proces një rol të rëndësishëm ka mendimi i studentëve, i cili tërhiqet me anë të anketave, ku pyeten edhe për format dhe metodat e mësimdhënies; - Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive	Nga shqyrtimi i programeve të lëndëve të programit të studimit, konstatohet që testimi dhe vlerësimi i dijeve të studentëve të programit të studimit, realizohet përgjatë gjithë semestrit

profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	akademik. Janë përcaktuar dy periudha kohore të dedikuara për provimet përfundimtare. Provimet e ndërmjetme apo vlerësimi i vazhdueshëm bëhet gjatë semestrit me miniteste, projekte, detyra kursi sipas syllabusit përkatës por në përgjithësi 40% të vlerësimin përfundimtar studenti e grumbullon nga vlerësimi i vazhdueshëm dhe 60% nga provimi përfundimtar. Programi i studimit ka profil të theksuar profesional dhe vlerësimi i studentit përveç njohurive, bazohet dhe në aftësi të profesionale. <i>(Rregullore e studimit evidence 1.3)</i> <i>(Programi i studimit evidence 2.3)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimin, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Testimet dhe provimet e parashikuara për lëndët/modulet e programit të studimit zhvillohen gjithnjë me komisione provimi me të paktën dy pedagogë. Pedagogu i lëndës ka peshën kryesore në vlerësimin përfundimtar duke përfshirë dhe elementët e vlerësimin në vazhdim. Rezultatet përfundimtare të provimit janë bërë të ditur studentëve në platformën online.. Rregulloret e Institucionit janë të pasqyruara në faqen e internetit. <i>(Rregullore fakultetit evidence 1.4)</i> <i>(Rregullore programi studimi evidence 1.3)</i> <i>(Programi i studimit evidence 2.3)</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Referuar rregullores së programit si dhe takimeve me stafin dhe studentët e programit, testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga pedagogu i lëndës ose nga komisioni i pedagogëve në varësi të lëndës specifike. Detyrat, prezantimet në klasë, projektet, raste studimore, etj, vlerësohen nga pedagogu i lëndës dhe asistenti mesimor. <i>(Rregullore programi studimi evidence 1.3)</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Nga takimi me stafin akademik dhe studentët e programit, rezultoi se në fletën e provimit pasqyrohen pikët e grumbulluara si dhe komentet përkatëse për gabimet e bëra. Komentet i përcohen edhe studentit, i cili ka të drejtë ti dijë ato. Në fund të ballafaqimit me studentët pedagogu bën vlerësimin përfundimtar të studentit. <i>(Rregullore programit të studimit evidence 1.3)</i>

Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Universiteti, nëpërmejt rregulloreve të hartuara, dënon kopjen dhe plagjiaturën. Studenti penalizohet nëse vihen re raste të kopjimit apo të plagjiaturës gjatë realizimit të detyrimeve akademike të tij. <i>(Rregullore fakultetit evidence 1.4)</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Afatet e përfundimit të vlerësimit janë të përcaktuara qartë dhe të shpallura edhe në kalendarin akademik të universitetit. Finalizimi i notave realizohet në përgjithësi maksimalisht një javë pas periudhës së provimit përfundimtar. <i>(Rregullore e secretaries evidence 3.31)</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Studentëve u ofrohet e drejta të ankimojnë rezultatet e tyre duke paraqitur kërkesë me shkrim pranë Departamentit përkatës. Departamenti ngre një komision të posaçëm i cili rivlerëson tezën në prani të studentit dhe pedagogut të lëndës. I gjithë ky process dokumentohet në department. <i>(Rregullore fakultetit evidence 1.4)</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe realizohet me provim me shkrim dhe me detyra, projekte/ese, raste studimore, etj; - Format e kontrollit të dijes janë të përcaktuara në syllabusin e çdo lënde është i ndërtuar në mënyrë që të jepet informacion i detajuar për mënyrën e vlerësimit të vazhdueshëm dhe provimet; - Institucioni angazhohet në zbatimin e rregulloreve të fakultetit në lidhje me metodologjinë e testimit dhe vlerësimit

	të studentëve duke mbështetur fort vlerësimin sipas meritokracisë;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Mbështetur në PS, GVJ është e mendimit se përbërja e planit mësimor si dhe zhvillimi i lëndëve garantojnë mundësinë për thellimin e njohurive, si dhe zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve. Përbajtja e programit të studimit Bachelor në Teknik Imazherie i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje me nivelin e ciklit të parë të studimeve. Krahas njohurive shkencore teorike, programi synon aftësimin praktik të studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave. <i>(Plani mesimor Ba ne TI evidence2.3)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Referuar planit mësimor 11% e kurrikulës është e përbërë nga lëndë të tipit D, që garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit, dhe ndërveprimit si Biostatistikë. Anglishte profesionale, etj. <i>(Plani mësimor evidence 2.3) (Programet evidence2.10)</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e	Syllabuset e lëndëve paraqesin përshkrimin e temave dhe lëndëve, numrin e krediteve, etj dhe me rëndësi të veçantë është përshkrimi i objektivave të lëndës. Çdo lëndë ka objektivat e saj në lidhje me kompetencat që duhet të arrijnë studentët në fund të lëndës së zhvilluar dhe është në lirinë akademike të pedagogëve të zgjedhin metodologjinë dhe format më të mira të arritjes së tyre. Për këtë arsye syllabuset analizohen dhe shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme në funksion të rezultateve sa më të mira të studentëve e konkulluar kjo në rezultatin e provimeve, punësimin e studentëve dhe opinionin e vet studentëve në fund të përfundimit të lëndës. Pedagogët në orën e parë të leksionit njohin studentët me syllabusin e lëndës,

tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	me objektivat, temat, të drejtat dhe detyrimet, format e vlerësimit, etj, si dhe orientojnë studentët me anë të konsultimeve drejt çështjeve më të rëndësishme si në zhvillimin e provimit të lëndës, ashtu edhe në detyrimet përmbyllëse. Mësimi ka interaktivitet dhe komunikim të rrjedhshëm me studentin gjë e cila shërben dhe për ngritjen e problemeve të ndryshme si dhe orientimin e studentëve për zgjidhjen dhe implementimin e tyre në sferën praktike.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirëpercaktuara në programet lëndore. Studentët e programit Bachelor në Teknik Imazherie kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme dhe e përdorin atë për të zhvilluar njohuritë e marra në laboratorët kompjuterikë, në laboratorët mjekësore, si dhe në praktikat profesionale. Mbështetur në informacionin e siguruar gjatë takimeve me stafin akademik, studentët, por edhe syllabuseve, stafi akademik inkurajon, nxit dhe mbështet punën në grup të studentëve, për rastet studimore dhe për projektet e kursit. Diskutimet dhe puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme është listuar si një ndër kompetencat e programit Bachelor në Teknik Imazherie. <i>(Kurrikula e programit të studimit evidence 2.3) (Syllabuset e Lëndëve të PS)</i>
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	GVJ konstaton nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion, se stafi akademik i programit, ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të zhvilluara, në të cilat ata informohen rreth inovacioneve dhe arritjeve të shkencës. Stafi akademik mbështetet nga Departamenti dhe Universiteti për realizimin e aktiviteteve të ndryshme si leksione të hapura, konferenca, ëorkshope etj.
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i>

	- Programi i studimit ka në përbërje lëndë të rëndësishme dhe bashkëkohore të fushës së imazherisë dhe radioterapisë të cilat mundësojnë pasurimin e studentit me informacione dhe njohuri bazë në këtë fushë dhe garantojnë thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve; - Syllabuset analizohen dhe shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme në funksion të rezultateve sa më të mira që duhet të arrijnë në përfundim të lëndës së zhvilluar; - institucioni angazhohet në përmirësimin e metodave të mësimdhënies e cila realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirëpecaktuara në programet lëndore;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar në DVV si dhe nga informacioni i siguruar nga takimi me studentët, GVJ konstaton se institucioni ka një procedurë të posaçme për provimin final, ose mbrojtjen e diplomës, e sanksionuar në rregulloren e institucionit. Institucioni e bën atë publike në faqen e internetit nga ku studentët mund ta aksesojnë lehtësisht. (Rregullore e Universitetit WBU evidence 1.2)
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Informacioni dhe udhëzimet për provimin final janë vënë në dispozicion të studentëve dhe është e publikuar dhe në faqen online. Pedagogët përgjegjës përgatisin një program mbështetës për provimin përfundimtar. Në raste të caktuara pedagogët janë të disponueshëm për ofrimin e konsultimeve për studentët gjatë procesit të përgatitjes së tyre për provimin përfundimtar. (Syllabuset e lendeve evidence 2.10)

	<i>(Programi i studimit evidence 2.3)</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Provimi i përgjithshëm përfundimtar është i përbërë nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura nga lëndët teknike që studentët kanë ndjekur gjatë studimeve të tyre bachelor. Përqindja e secilit grup pyetjesh përcaktohet në bazë të ngarkesës së tyre ECTS në kurrikul dhe raportit të tyre me lëndët e tjera. Komisioni i Departamentit përgatit provimin e përgjithshëm përfundimtar bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, sipas përqindjes së përcaktuar. <i>(Vendim dekani për komisionin e provimeve të diplomimit evidence 5.15)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Pedagogët përgjegjës plotësojnë një program lëndor (syllabus-et) për provimin e diplomimit dhe e shpërndajnë atë tek studentët në fillim të semestrit. Pedagogët punojnë me studentët e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur dhe ndajnë me to të gjitha materialet që mund t'i ndihmojnë ato në përgatitjen për provimin përfundimtar. <i>(Rregullore e provimit online evidence 5.15)</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Universiteti ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën e nevojshme, si dhe staf ndihmës për të asistuar studentët në përgatitjen për provimin përfundimtar. Studentët mund të shfrytëzojnë bibliotekën fizike dhe online për sigurimin e informacioneve të nevojshme për të realizuar kërkimin shkencor si dhe për të kryer analiza krahasuese në varësi të fushës së studimit. Studentët mund të përdorin kompjuterat e laboratorit të institucionit për të kryer studimin.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së	Provimi përfundimtar dhe projekti i diplomimit vlerësohet me notë, nga komisioni përgjegjës për koordinimin e provimin të diplomës. <i>(Rregullore e fakulteti evidence 1.4t)</i>

diplomës, studenti vlerësohet me notë.				
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë dhe kompletimin e 180 ECTS, zyrat përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Në përfundim të studimeve studenti pajiset me Diplomën përkatëse si dhe me Suplementin e Diplomës. <i>(Rregullore e fakultetit evidence 1.4)</i> <i>(Formati i suplementit TI evidence3.29)</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Referuar RVB-së, WBU arkivon kopje të dokumentacionit të studentit për një afat të pacaktuar dhe rast pas rasti bazuar në kërkesat e studentit lëshohen vërtetime me qëllime të ndryshme. Institucioni i ruan ato sipas ligjit për ruajtjen e të dhënave dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. Sekretaria lëshon dokumente të ndryshme të miratuara nga institucioni me kërkesë të studentit sipas modeleve të paracaktuara.			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - WBU ka hartuar rregullore të posaçme për provimin e përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës; - Studentët orientohen për zhvillimin e provimit të përgjithshëm, dhe tezat e provimit hartohen nga komisioni i caktuar me pyetje të disiplinave Lëndë Karakterizuese; - WBU ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të të gjithë studentëve të rregjistruar në të gjithë ciklet e studimit për një kohë të caktuar;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur dhe intervistat e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstatohet se personeli akademik dhe ndihmës akademik i angazhuar në programin e studimit përmbush kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e kualifikimit akademik dhe për përputhjen me fushën e studimit. Personeli akademik i përfshirë në program zotëron tituj shkencorë dhe akademikë të përshtatshëm për nivelin e ciklit të studimeve. Për lëndët kryesore mbulimi sigurohet nga personel me kualifikime të plota dhe përvoja kërkimore ose praktike të lidhura ngushtë me profilin e programit. Ngarkesat mësimore janë të shpërndara në mënyrë të balancuar ndërmjet stafit të brendshëm dhe atij të jashtëm. Institucioni ka marrë masa për të shmangur mbingarkesat e stafit, duke respektuar normat ligjore për orët dhe për detyrimet e tjera akademike. Struktura përfshin staf ndihmës të specializuar, i cili ofron mbështetje për zhvillimin e praktikave, laboratorëve dhe shërbimeve të tjera të domosdoshme për programin. <i>(Evidenca 4.1 Numri i personelit akademik per cdo njesi baze)</i> <i>(Evidenca 1.10 Rregullorja mbi organizimin akademik te WBU)</i> <i>(Tabelat permbledhese)</i> <i>(Evidenca 2.6 Lista e personelit asistent lektor, ndihmes akademik/administrativ i angazhuar ne realizimin e praktikave mesimore)</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i listës së personelit dhe orëve të ngarkesës mësimore, rezulton se programi i studimit siguron mbulim efektiv të ngarkesës në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Lëndët kryesore dhe të detyrueshme janë të mbuluara nga personel i brendshëm me status të plotë, ndërsa për disa lëndë të specializuara mbështetja realizohet nga staf i jashtëm i kualifikuar.

	Për vitin akademik 2022-2023, numri i stafit efektiv të brendshëm i angazhuar në programin e studimi është 18, dhe numri i stafit akademik me kohë të pjesshme është 5. Për vitin akademik 2023-2024, numri i stafit efektiv të brendshëm i angazhuar në programin e studimi është 17, dhe numri i stafit akademik me kohë të pjesshme është 13. Për vitin akademik 2024-2025, numri i stafit efektiv të brendshëm i angazhuar në programin e studimi është 22, dhe numri i stafit akademik me kohë të pjesshme është 10. Ngarkesa është e shpërndarë në mënyrë të barabartë, duke respektuar kufizimet për orët maksimale dhe duke shmangur mbingarkimin individual të pedagogëve. <i>(Evidenca 4.1 Numri i personelit akademik per cdo njesi baze)</i> <i>(Evidenca 1.10 Rregullorja mbi organizimin akademik te WBU)</i> <i>(Tabelat permbledhese)</i> <i>(Evidenca 2.6 Lista e personelit asistent lektor, ndihmes akademik/administrativ i angazhuar ne realizimin e praktikave mesimore)</i> <i>(Evidenca 4.4 Udhezimi per ngarkesen mesimore)</i> <i>(Evidenca 4.7 Lista e stafit akademik sipas njësive bazë)</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Nga analiza e dokumentacionit dhe të dhënave të paraqitura nga universiteti, rezulton se WBU garanton një nivel të kënaqshëm qëndrueshmërie të personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit. Universiteti ka paraqitur kopje të kontratave të punës për stafin efektiv të brendshëm, të cilat janë të lidhura në përputhje me kornizën ligjore. Kohëzgjatja e kontratave reflekton angazhimin afatmesëm dhe afatgjatë të stafit në institucion, duke krijuar stabilitet në mbulimin e moduleve. Në evidencat e raportit si dhe takimi fizik i kryer në institucion mundësoi paraqitjen e dokumentacionit mbi mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore për stafin efektiv, çka përbën një element të rëndësishëm të garantimit të marrëdhënieve të qëndrueshme të punës. Nga të dhënat rezulton se një pjesë e stafit efektiv është e angazhuar në institucion që prej fillimit të programit të studimit, duke siguruar vazhdimësi në ofrimin e mësimdhënies dhe në përmbushjen e objektivave të programit. <i>Megjithatë, vihet re se për disa lëndë të specializuara mbulimi realizohet</i>

	<i>ende nga staf i jashtëm me kontrata afatshkurtra, çka mund të ndikojë në pasigurinë e jetëgjatësisë së personelit me kohë të pjesshme.</i> <i>(Evidenca 4.7 Lista e stafit akademik sipas njësive bazë)</i> <i>(Tabelat permbledhese)</i> <i>(Evidenca 4.8 Kontrata e punes se personelit akademik)</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion, konstatohet se institucioni ka në funksion procedura të qarta rekrutimi dhe vlerësimi të personelit akademik. Procesi i përzgjedhjes së personelit akademik realizohet mbi bazën e shpalljeve publike dhe kritereve të përcaktuara nga kuadri ligjor dhe rregulloret e brendshme të institucionit. Dokumentacioni i paraqitur tregon se kandidaturat vlerësohen në përputhje me nivelin e kualifikimit akademik dhe përvojën e tyre kërkimore ose praktike, në raport me kërkesat e programeve të studimit. Institucioni ka mekanizma për vlerësimin periodik të performancës së stafit akademik, të cilët lidhen me cilësinë e mësimdhënies, aktivitetin kërkimor, angazhimin në mbështetje të studentëve dhe pjesëmarrjen në veprimtari akademike. Nga intervistat rezulton se këto vlerësime përdoren për zhvillimin profesional të stafit dhe për përmirësimin e cilësisë së programeve. Evidencat tregojnë se përzgjedhja e stafit është bërë duke marrë parasysh natyrën, strukturën dhe modulet e programit. <i>(Tabelat permbledhese)</i> <i>(Evidenca 4.7 Lista e stafit akademik sipas njësive bazë)</i> <i>(Evidenca 4.15 Procedura e punësimit në WBU)</i> <i>(Evidenca 4.13 Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performances se stafit)</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e mjediseve	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga intervistat gjatë vizitës, konstatohet se institucioni ka në dispozicion personel ndihmës akademik të angazhuar për të mbështetur realizimin e orëve praktike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve mësimore të programit. Numri i personelit ndihmës është në përputhje me natyrën e programit dhe me orët e planifikuara për punë praktike. Megjithatë, u evidentua gjatë vizitës se në periudha të ngarkuara (si zhvillimi i projekteve studentore ose praktikave

të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	<i>intensive), mbështetja është e kufizuar dhe do të përfitonte nga një rritje e mëtejshme e stafit.</i> <i>(Evidenca 2.6 Lista e personelit asistent lektor, ndihmes akademik/administrativ i angazhuar në realizimin e praktikave mësimore)</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Nga dokumentacioni i paraqitur dhe nga intervistat e zhvilluara gjatë vizitës, konstatohet se institucioni mbledh, ruan dhe përditëson në mënyrë sistematike të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Institucioni mban një databazë të strukturuar për personelin akademik, ndihmës dhe administrativ, ku përfshihen të dhënat identifikuese, kualifikimet, statusi i kontratës dhe ngarkesa mësimore për çdo vit akademik. Dokumentacioni i paraqitur dëshmon se këto të dhëna ruhen në përputhje me standardet ligjore dhe janë të aksesueshme për organet përgjegjëse brenda institucionit. Të dhënat përditësohen në fillim të çdo viti akademik dhe pasqyrojnë angazhimin e secilit anëtar të stafit sipas semestrave dhe viteve akademike. Ky proces mundëson monitorimin e vazhdueshëm të mbulimit të lëndëve dhe të mbarëvajtjes së programit. Për të mos cënuar mbrojtjen e të dhënave personale, institucioni siguron akses të kufizuar dhe të kontrolluar mbi databazën e stafit. <i>(Evidenca 1.11 Rregullorja mbi organizimin administrativ në WBU)</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga takimet gjatë vizitës, konstatohet se institucioni ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, si dhe me institucione partnere në fushën spitalore duke përmendur American Hospital dhe International Hygeia Hospital, duke garantuar mbështetjen e studentëve në praktikën profesionale dhe në proceset përfundimtare të programit. Për zhvillimin e praktikave profesionale, universiteti siguron personel të kualifikuar si nga stafi i brendshëm akademik ashtu edhe nga përfaqësues të institucioneve partnere. Nga evidencat rezulton se studentët udhëhiqen nga një kombinim i pedagogëve të programit dhe mentorëve të jashtëm. Institucioni ka përcaktuar procedura të qarta për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e punimeve të diplomës, duke angazhuar staf

të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	akademik të kualifikuar në fushat përkatëse. Kjo garanton që studentët të marrin udhëzimin e nevojshëm për të realizuar projekte cilësore. <i>Numri i personelit të përfshirë në mbikëqyrjen e praktikave dhe punimeve është i mjaftueshëm për të mbuluar nevojat e studentëve, megjithatë u evidentua se nevojitet koordinim i mëtejshëm për të standardizuar cilësinë e mentorimit të ofruar nga partnerët e jashtëm.</i> <i>(Evidenca 4.17 Lista e institucioneve akademike partnere)</i> <i>(Evidenca 1.9 Marreveshje bashkepunimi te WBU me American Hospital dhe Hygeia Hospital)</i> <i>(Evidenca 1.12 Marreveshje bashkepunimi me Cambridge Clinical Labs)</i>
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	GVJ konstaton se, institucioni ka marrë masa për të siguruar përfshirjen e personelit mbikëqyrës në ambientet pritëse, në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara. Personeli mbikëqyrës në institucionet dhe kompanitë pritëse ndihmon studentët në procesin e integritetit në praktikë dhe në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në program. Studentët konfirmuan se mentorët e jashtëm ofrojnë udhëzime praktike dhe këshilla profesionale gjatë gjithë periudhës së praktikës. Sipas procedurave të universitetit, personeli mbikëqyrës ndihmon studentët në hartimin e raportit përfundimtar të praktikës duke dhënë udhëzime mbi përmbajtjen, objektivat dhe reflektimin e përvojës praktike. Evidencat tregojnë se mentorët e jashtëm marrin pjesë në procesin e vlerësimit të studentëve për praktikën profesionale, përmes plotësimit të formularëve të vlerësimit dhe dhënies së feedback-ut zyrtar mbi performancën e studentit. Ky proces përforcon besueshmërinë dhe objektivitetin e vlerësimit final. <i>Gjatë vizitës u evidentua se përfshirja e mentorëve të jashtëm në procesin e vlerësimit ndryshon nga një partner tek tjetri, duke krijuar mungesë uniformiteti në standardet e vlerësimit.</i> <i>(Evidenca 1.2 Rregullorja Themelore e WBU)</i> <i>(Evidenca 1.9 Marreveshje bashkepunimi te WBU me American Hospital dhe Hygeia Hospital)</i> <i>(Evidenca 1.12 Marreveshje bashkepunimi me Cambridge Clinical Labs)</i>

Konkluzione	GVJ konstaton se: - Personeli akademik dhe ndihmës akademik i angazhuar në programin e studimit ka kualifikimet dhe përvojën e nevojshme për të siguruar mbulim të plotë të lëndëve dhe zhvillim të aktiviteteve praktike. - Proceset e rekrutimit, vlerësimit dhe menaxhimit të stafit janë të strukturuar dhe transparente, duke garantuar stabilitet dhe qëndrueshmëri në ofrimin e mësimdhënies, si dhe mbështetje efektive për studentët gjatë praktikave profesionale. - Megjithatë, rekomandohet përmirësimi i koordinimit dhe standardizimi i mentorimit dhe vlerësimit të studentëve nga partnerët e jashtëm për të rritur uniformitetin dhe cilësinë e përvojës praktike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ konstaton se, institucioni ka marrë masa për të siguruar mjediset e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në përputhje me numrin e studentëve dhe natyrën specifike të programit të studimit. Auditorët dhe sallat e mësimi janë të pajisura me infrastrukturën bazike didaktike dhe përdoren në mënyrë të rregullt për leksione dhe seminare. Evidencat tregojnë se kapaciteti i mjediseve është i përshtatshëm për grupet mësimore aktuale, ndërkohë që për programe të caktuara janë të disponueshme edhe ambiente laboratorike, megjithëse sugjerohet përditësim i vazhdueshëm i pajisjeve. Studentët konfirmuan se mjediset janë funksionale dhe mbështesin procesin mësimor, duke ofruar kushte të përshtatshme për zhvillimin e leksioneve, seminareve dhe aktiviteteve praktike. Gjithashtu, institucioni ka në përdorim bibliotekën dhe mjedise ndihmëse për studim individual dhe në grup, si edhe platforma dixhitale për mësim online dhe komunikim me studentët. Ky kombinim i infrastrukturës fizike dhe virtuale kontribuon në

	ofrimin e një mjedisi gjithëpërfshirës për mësimdhënie dhe të nxënë. <i>(Evidenca 4.18 Fragmenti I Hartes Kadastrale)</i> <i>(Evidenca 4.19 Planimetria e Kampusit)</i> <i>(Evidenca 4.20 Kontrata e qirase)</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ konstaton se, institucioni ka siguruar mjedise mësimore të pajisura me mjete elektronike dhe teknologji të informacionit, të cilat mbështesin zhvillimin e procesit teorik dhe praktik. Auditorët janë të pajisur me projektorë, kompjutera dhe akses në rrjet, duke lehtësuar përdorimin e materialeve digjitale gjatë leksioneve dhe seminareve. Evidencat tregojnë se laboratorët dhe studiot janë funksionale dhe të përdorshme për qëllime praktike, megjithëse në disa raste kërkohet përditësim i pajisjeve për t'u përshtatur me zhvillimet bashkëkohore në fusha specifike të programeve të studimit. Studentët konfirmuan se përdorimi i mjeteve teknologjike kontribuon ndjeshëm në kuptimin e lëndëve dhe në përvetësimin e aftësive praktike. Gjithashtu, institucioni përdor platforma online për menaxhimin e mësimdhënies, shpërndarjen e materialeve mësimore dhe komunikimin me studentët, duke integruar metodologji bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies dhe duke ofruar fleksibilitet në procesin akademik. <i>(Evidenca 4.23 Plan shpërndarja e Smart Boards)</i> <i>(Evidenca 4.24 Lista e Laboratoreve)</i> <i>(Evidenca 4.25 Inventar Laboratori)</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	GVJ konstaton se, institucioni ka vënë në dispozicion laboratorë, studio dhe mjedise të tjera praktike, të pajisura me aparaturat dhe mjetet e nevojshme në funksion të moduleve dhe objektivave formues të programeve të studimit. Këto ambiente mbështesin zhvillimin e kompetencave praktike të studentëve, në përputhje me natyrën specifike të fushës të studimit. Evidencat tregojnë se laboratorët janë të përdorshëm për zhvillimin e ushtrimeve praktike dhe aftësimin profesional. Studentët konfirmuan se pajisjet bazike janë të pranishme dhe të funksionale, duke u ofruar mundësinë të ushtrojnë aftësitë teorike në kushte praktike.

Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Gjithashtu, institucioni ka ndërmarrë hapa për të garantuar mirëmbajtjen dhe përdorimin e rregullt të aparaturave, megjithëse në disa raste evidentohet nevoja për pasurimin dhe modernizimin e tyre, në mënyrë që të jenë në përputhje me zhvillimet bashkëkohore dhe kërkesat e tregut të punës. <i>(Evidenca 4.23 Plan shpërndarja e Smart Boards)</i> <i>(Evidenca 4.24 Lista e Laboratoreve)</i> <i>(Evidenca 4.25 Inventar Laboratori)</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - WBU ka siguruar një infrastrukturë mësimore të përshtatshme dhe funksionale, duke përfshirë auditorë, laboratorë dhe mjedise ndihmëse, të pajisura me teknologji dhe mjete didaktike që mbështesin zhvillimin e procesit teorik dhe praktik. - Përdorimi i platformave online dhe kombinimi i mjediseve fizike dhe virtuale ofrojnë një mjedis gjithëpërfshirës për mësimdhënie dhe mësimnxënie. - Megjithatë, rekomandohet përditësimi i vazhdueshëm i pajisjeve laboratorike për t'u përshtatur me zhvillimet bashkëkohore dhe kërkesat e tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të	Bazuar në vlerësimin e kryer, konstatohet se institucioni siguron literaturë bazë dhe ndihmëse në gjuhën e programit të studimit, në format fizik dhe digjital, e cila mbështet në mënyrë efektive përvetësimin e njohurive dhe kompetencave të parashikuara në program. Duke ofruar mundësinë e qasjes tek literatura fizike, si dhe tek disa burime digjitale, çka përbën një vlerë të shtuar për studentët. Ky kombinim i burimeve i mundëson atyre të përvetësojnë njohuritë dhe kompetencat e nevojshme në

parashikuara në programin e studimit.	mënyrë më të plotë dhe fleksibël, duke përforcuar procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. <i>(Evidenca 4.30 Dokumenti i abonimit JSTOR)</i> <i>(Evidenca 4.31 Akses ne Resear4Life)</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Bazuar në vlerësimin e kryer, konstatohet se njësia përgjegjëse për literaturën akademike përditëson rregullisht burimet mësimore, duke përfshirë botime të reja dhe materiale bashkëkohore, duke garantuar që studentët të kenë akses në literaturë të përditësuar që mbështet zhvillimin e njohurive dhe kompetencave sipas programit të studimit. Për më tepër, universiteti siguron akses në burime digjitale ndërkombëtare, si JSTOR dhe Research4Life, të cilat ofrojnë literaturë shkencore të përditësuar dhe relevante, duke përforcuar mundësitë e hulumtimit dhe zhvillimit akademik për studentët dhe stafin. <i>(Evidenca 4.30 Dokumenti i abonimit JSTOR)</i> <i>(Evidenca 4.31 Akses ne Resear4Life)</i> <i>(Evidenca 4.32 Lista e Librave)</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni ofron akses të barabartë për studentët në bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit të burimeve fizike dhe digjitale për zhvillimin e njohurive dhe aftësive të parashikuara në programin e studimit. Ky akses kontribuon në mbështetjen e mësimdhënies dhe mësimnxënies, si dhe promovon një mjedis gjithëpërfshirës për studim individual dhe në grup. Përditësimi i literaturës bëhet me fondin e përcaktuar për bibliotekën bazuar në kërkesat e njësive bazë. <i>Rekomandohet përditësim i plotë literature me botime të pesë viteve të fundit duke qenë se vërehen disa mungesa.</i> <i>(Evidenca 4.30 Dokumenti i abonimit JSTOR)</i> <i>(Evidenca 4.31 Akses ne Resear4Life)</i> <i>(Evidenca 4.32 Lista e Librave)</i> <i>(Evidenca 4.34 Rregullorja e Bibliotekes)</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të	Biblioteka e institucionit është e pajisur me fond fizik të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm për mbulimin e moduleve të programit të studimit, duke përfshirë tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, libra dhe revista shkencore në gjuhën shqipe dhe të huaja.

huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Ky fond siguron që studentët të kenë akses në burime të nevojshme për zhvillimin e njohurive dhe kompetencave të kërkuara nga programi, duke mbështetur në mënyrë efektive procesin mësimor dhe veprimtaritë praktike të tyre. <i>(Evidenca 4.34 Rregullorja e Bibliotekes)</i> <i>(Evidenca 4.35 Praktika e kërkeses për pasurimin e fondit të Bibliotekes)</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	WBU ka krijuar kushte të qëndrueshme për qasje të barabartë dhe pa pagesë të studentëve në bibliotekat online dhe burimet digjitale të fushës së programit të studimit. Aksesimi përfshin platforma ndërkombëtare si JSTOR dhe Research4Life, si dhe burime të tjera digjitale relevante, të cilat ofrojnë literaturë shkencore të përditësuar dhe materiale mbështetëse për zhvillimin e njohurive dhe kompetencave të studentëve. Në këtë mënyrë, insitucioni siguron mundësi të gjerë për hulumtim, studim individual dhe në grup, si dhe mbështet përdorimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies. <i>(Evidenca 4.30 Dokumenti i abonimit JSTOR)</i> <i>(Evidenca 4.31 Akses ne Resear4Life)</i> <i>(Evidenca 4.32 Lista e Librave)</i> <i>(Evidenca 4.34 Rregullorja e Bibliotekes)</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka është e pajisur me kompjutera, programe kompjuterike dhe pajisje teknike që sigurojnë akses të plotë dhe pa kufizim për studentët në koleksione dhe burime informacioni të nevojshme për studime dhe punë shkencore. Hapësira e bibliotekës është e gjerë dhe e pajisur me infrastrukturë teknike e teknologjike që garanton kushte optimale për kërkim dhe studim. Qasja në burimet elektronike ofrohet në të gjithë kompjuterët e lidhur me rrjetin e WBU-së, si dhe nëpërmjet autentifikimit me email institucional, ndërsa hyrja nga jashtë kampusit mundësohet përmes autentifikimit "remote", në varësi të licencave të disponueshme. Gjithashtu, stafi i bibliotekës ofron asistencë të vazhdueshme për studentët dhe personelin, si për shfrytëzimin e fondit fizik ashtu edhe për burimet online, duke garantuar një mbështetje efektive në procesin mësimor dhe kërkimor. <i>(Evidenca 4.34 Rregullorja e Bibliotekes)</i>




Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Bazuar në vlerësimin e kryer, konstatohet se Biblioteka e vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi të përshtatura me zhvillimin e procesit mësimor dhe përtej tij, duke marrë parasysh nevojat, numrin e studentëve dhe kapacitetin e saj. Fondi fizik mund të shfrytëzohet gjatë orarit zyrtar të punës, 08:30 – 16:30, të shpallur në ambientet e bibliotekës dhe të publikuar online, ndërsa fondi digjital është i aksesueshëm në cdo kohë përmes faqes zyrtare të bibliotekës dhe platformës “SMART-WBU”, duke u loguar me kredencialet personale të studentëve dhe stafit akademik. Përveç huazimit të materialeve fizike dhe aksesit falas në burime online, biblioteka mundëson edhe rezervimin e hapësirave të studimit sipas nevojave të përdoruesve, duke krijuar një mjedis gjithëpërfshirës dhe fleksibël për mësimnxënie dhe kërkim. <i>(Evidenca 4.34 Rregullorja e Bibliotekës)</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Biblioteka, në bashkëpunim me njësitë përgjegjëse të programeve të studimit, ndjek dhe raporton në mënyrë të rregullt për cilësinë e fondit fizik dhe atij online, duke evidentuar titujt kryesorë në shërbim të programeve, përditësimin e tyre, si dhe shkallën e shfrytëzimit nga studentët dhe personeli akademik. Raportimet përfshijnë gjithashtu përdorimin e sallave të studimit dhe nxjerrin në pah efektivitetin e përpjekjeve për pasurimin e fondit me tituj të rinj, si dhe kërkesat e ardhura nga stafi akademik për përmirësimin e mëtejshëm të koleksioneve. Biblioteka njofton rregullisht përdoruesit mbi prurjet e reja në fondin fizik dhe online, si dhe mbi anëtarësimet në databaza shkencore. Vihet re një bashkëpunim i vazhdueshëm ndërmjet bibliotekës dhe njësisë bazë dhe atyre kryesore me qëllim sigurimin e literaturës së nevojshme për zhvillimin e lëndëve, duke reflektuar nevojat reale të mësimdhënies dhe kërkimit. <i>(Evidenca 4.37 Praktikë për informimin e personelit akademik për cilësinë e fondit fizik dhe fondit online të bibliotekës/ Raporti vjetor i bibliotekës së WBU 20223-2024)</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Biblioteka ofron një kombinim të balancuar të fondit fizik dhe atij online, duke siguruar akses të barabartë dhe pa pagesë për studentët dhe stafin akademik. - Përdoruesit kanë në dispozicion hapësira funksionale studimi, pajisje teknike dhe qasje në platforma

	<i>ndërkombëtare të literaturës shkencore, të cilat mbështesin procesin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimit.</i> - <i>Megjithatë, rekomandohet vijimi i pasurimit të fondit me botime të reja dhe zgjerimi i bashkëpunimeve për të garantuar përshtatjen e vazhdueshme me zhvillimet bashkëkohore akademike dhe shkencore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	WBU ka ngritur një sistem të konsoliduar menaxhimi të informacionit nëpërmjet platformës SMART-WBU, e cila siguron digjitalizimin dhe administrimin e plotë të të dhënave të studentëve nga regjistrimi deri në diplomim. Ky sistem menaxhimi përdoret nga personeli akademik, administrativ dhe studentët, duke mundësuar informatizimin e dokumentacionit dhe procedurave institucionale në përputhje me kërkesat e akteve rregullatore të brendshme, përfshirë Statutin, Rregulloren Themelore dhe Rregulloren mbi organizimin administrativ. Gjithashtu, universiteti ruan kopje fizike dhe elektronike të dokumentacionit të studentëve, duke garantuar integritetin dhe aksesueshmërinë e të dhënave në përputhje me dispozitat ligjore për arkivimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Zyra e Sekretarisë Mësimore dhe Zyra e Protokollit dhe Korrespondencës janë strukturat që administrojnë dhe ruajtjen e dokumentacionit, duke siguruar regjistrimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo informacioni lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre akademik. <i>(Evidenca 1.1 Statuti)</i> <i>(Evidenca 1.2 Rregullorja Themelore e WBU)</i> <i>(Evidenca 3.31 Rregullorja e Zyres së Sekretarisë Mesimore)</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit	Konstatohet se Institucioni ka të ngritur një sistem të brendshëm menaxhimi, i cili administron në mënyrë të

administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	strukturuar informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në realizimin e programeve të studimit. Në përputhje me Nenin 32 të Rregullores mbi organizimin administrativ, Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit çdo vit akademik, duke përfshirë lëvizjet ndërdepartamentale dhe angazhimin në semestra të ndryshëm. Kjo praktikë garanton monitorim të vazhdueshëm dhe menaxhim efektiv të burimeve njerëzore në raport me nevojat e fakulteteve dhe programeve. Gjithashtu, sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar dhe transparent në informacione e dokumente për personelin dhe studentët. Të dhënat kryesore mbi programet e studimit – si emërtimi, kurrikula, departamenti dhe fakulteti përgjegjës, si dhe stafi akademik i angazhuar – janë të publikuara dhe të aksesueshme për publikun në faqen zyrtare të universitetit, duke rritur transparencën institucionale dhe duke forcuar besueshmërinë e procesit të menaxhimit akademik dhe administrativ. <i>(Evidenca 3.30 Rregullorja për mbrojtjen, perpunimin, ruajtjen e të dhënave personale)</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit në WBU është i integruar me platforma dhe module funksionale, të cilat mundësojnë komunikim interaktiv dhe shkëmbim informacioni ndërmjet personelit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve. Çdo përdorues ka një hapësirë të dedikuar sipas rolit dhe pozicionit të tij, ndërsa studentët përmes llogarive të tyre kanë akses në sylabuse, materiale mësimore, vlerësime, prezencë, si dhe komunikim me këshilltarin akademik dhe shërbimet administrative.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Gjithashtu, konstatohet se sistemi i menaxhimit ofron monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, duke mundësuar raportime individuale dhe të dhëna të përditësuara për organet dhe autoritetet drejtuese të universitetit. https://smart.wbu.edu.al/
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin	WBU publikon të gjitha informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet institucionale në faqen e tij zyrtare të internetit, në përputhje me kriterin e

akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	kërkuar. Informacionet janë të disponueshme në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, duke garantuar transparencë dhe akses të gjerë si për studentët vendas ashtu edhe për ata të huaj. https://wbu.edu.al/en https://wbu.edu.al/sq			
Konkluzionc	GVJ konstaton se: - WBU ka ngritur një sistem të plotë menaxhimi dhe transparence, i cili garanton administrimin efikas të informacionit për studentët dhe personelin, si dhe akses të dedikuar në dokumentacion dhe shërbime online. - Platforma "SMART-WBU" siguron komunikim interaktiv, monitorim në kohë reale të aktiviteteve akademike e administrative, si dhe raportime të vazhdueshme. - Informacionet kryesore mbi programet e studimit dhe aktivitetet akademike publikohen në faqen zyrtare në dy gjuhë (shqip dhe anglisht), duke garantuar transparencë			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në vlerësimin e kryer, konstatohet se institucioni harton dhe miraton në mënyrë të rregullt raportin financiar vjetor, i cili përfshin analizën e të ardhurave, shpenzimeve, detyrimeve financiare dhe planeve mbështetëse për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Raporti, i integruar në raportin e veprimtarisë së institucionit, shqyrtohet nga organet drejtuese (Rektorati, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit), miratohet dhe publikohet, duke garantuar transparencë të plotë dhe respektim të akteve ligjore në fuqi. (Evidenca 4.38 Raport Vjetor)

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Institucioni, ka hartuar një plan financiar të detajuar dhe të strukturuar për njësitë bazë dhe programet e studimit, i cili përfshin financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse, fondet për bibliotekën, pasurimin e literaturës dhe aksesin në bibliotekat online, si dhe detyrimet financiare, grantet dhe kontratat e shërbimeve të lidhura me realizimin e programeve. Procesi i hartimit dhe miratimit të buxhetit kryhet në koordinim me njësitë bazë, Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit. Universiteti, si institucion privat, ka fleksibilitet për menaxhimin e blerjeve dhe tenderave, duke garantuar një administrim efikas dhe të qëndrueshëm të burimeve financiare në funksion të mbarëvajtjes së programeve të studimit. <i>(Evidenca 1.1 Statuti)</i> <i>(Evidenca 4.39 Buxheti vjetor i WBU)</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Institucioni, ka vendosur një sistem të efektshëm kontrolli buxhetor dhe financiar, duke kryer auditime periodike të brendshme për të vlerësuar dhe dokumentuar gjendjen e financimit dhe efektivitetin e tij. Përveç auditimeve të brendshme, universiteti parashikon edhe auditime të jashtme. <i>(Evidenca 4.41 Raporti i auditimit të brendshëm)</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Konstatohet se WBU siguron raportim të detajuar mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programet e studimit. Administratori i fakultetit është përgjegjës për menaxhimin financiar dhe administrativ, duke monitoruar shpenzimet, kontrolluar efektivitetin e përdorimit të buxhetit dhe plotësuar nevojat akademike dhe administrative. <i>(Evidenca 1.11 Rregullora mbi organizimin administrativ të WBU)</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë	Bazuar në raportimet financiare të institucioni, konstatohet se universiteti garanton qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e

financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	programeve të studimit dhe siguron kapacitetet e nevojshme për funksionimin normal të tyre. Institucioni monitoron periodikisht treguesit financiarë, rishikon buxhetin dhe rialokon fondet sipas nevojës, duke siguruar përdorim efektiv të burimeve në përputhje me ligjet dhe standardet kombëtare të kontabilitetit. <i>(Evidenca 1.11 Rregullora mbi organizimin administrativ të WBU)</i> <i>(Evidenca 4.41 Raporti i auditimit të brendshëm)</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Institucioni ka vendosur mekanizma të qartë dhe të efektshëm për menaxhimin dhe monitorimin e financave të programeve të studimit. - Sistemi i brendshëm administrativ dhe financiar siguron mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e informacionit financiar deri në nivelin e njësisë bazë, ndërsa Bordi i Administrimit garanton qëndrueshmërinë dhe përdorimin efikas të burimeve. - Institucioni kryen auditime periodike, planifikon ndërhyrje për përmirësimin e situatës financiare dhe diversifikon burimet e financimit, duke siguruar mbështetje të qëndrueshme për zhvillimin e programeve akademike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV

Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
----------------	-----------------------	----------------------	-----------------------

X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni ka hartuar një paketë të plotë politikash dhe procedurash që mbulojnë gjithë ciklin e jetës akademike të studentit nga pranimi deri në diplomim. Këto janë të miratuara në organet drejtuese dhe janë të harmonizuara plotësisht me kuadrin ligjor kombëtar. Ato përfshijnë rregulloret e studimeve, udhëzuesit e studentëve dhe akte të tjera të brendshme që sigurojnë një proces të qartë, të kuptueshëm dhe të standardizuar. Në praktikë, procedurat janë zbatuar me përpikëri, gjë që garanton koherencë dhe trajtim të barabartë për të gjithë studentët. <i>(Evidenca 1.2 Rregullora Themelore e WBU)</i> <i>(Evidenca 5.5 Kriteret e pranimi)</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni respekton parimin e mundësive të barabarta, duke i dhënë përparësi qasjes pa diskriminim në bazë gjinie, përkatësie etnike, statusi social ose gjendjeje shëndetësore. Procedurat e pranimi dhe përparimi janë të unifikuara dhe të zbatuara në mënyrë të njëjtë për të gjithë, ndërsa mekanizmat e ankimit dhe komisionet e posaçme garantojnë që studentët të kenë mundësi reale për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tyre. Praktika e deritanishme tregon se politika të tilla kanë ndihmuar në ruajtjen e një mjedisi të drejtë e të balancuar akademik. <i>(Evidenca 1.2 Rregullora Themelore e WBU)</i> <i>(Evidenca 5.5 Kriteret e pranimi)</i> <i>(Evidenca 5.2 Procedura e pranimi të studentëve të huaj)</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas	Institucioni publikon në kohë kriteret e pranimi dhe i përshtat ato sipas profileve të programeve të studimit, duke siguruar transparencë dhe barazi. Bashkëpunimi me strukturat shtetërore të maturës ka qenë korrekt dhe i rregullt, duke shmangur çdo paqartësi për kandidatët. Për studentët ndërkombëtarë, janë përcaktuar procedura të posaçme që përfshijnë dokumentacionin shtesë dhe njohjen e diplomave të huaja. Ky element i jep një dimension ndërkombëtar institucionit dhe kontribuon në rritjen e diversitetit kulturor.

ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	<i>(Evidenca 1.1 Statuti)</i> <i>(Evidenca 1.2 Rregullora Themelore e WBU)</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Institucioni siguron një transparencë të lartë duke publikuar të gjitha procedurat në faqen zyrtare të internetit, broshura dhe udhëzues për studentët. Dokumentet janë të formuluar me gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke lehtësuar përdorimin nga kandidatët dhe studentët aktualë. Një praktikë pozitive është edhe organizimi i aktiviteteve orientuese për studentët e rinj, ku shpjegohen hapat e procesit akademik. Ky nivel transparence ndihmon në rritjen e besimit dhe orientimin e saktë të studentëve. <i>(Evidenca 1.1 Statuti)</i> <i>(Evidenca 1.2 Rregullora Themelore e WBU)</i> <i>(Evidenca 5.4 Ditët e informimit brenda institucionit për studentët/organizimi i aktiviteteve informuese)</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Institucioni ka ngritur një sistem të rregullt informimi, i cili përfshin publikime në uebfaqe, rrjete sociale, media dhe shpesh edhe ditë të hapura (open days) për kandidatët. Përmes këtyre mekanizmave, kandidatët dhe familjarët e tyre marrin informacion të plotë dhe të besueshëm mbi kriteret e pranimit, lëndët e programit dhe perspektivat pas diplomimit. Kjo praktikë rrit transparencën dhe mundëson marrjen e vendimeve të informuara nga ana e studentëve. <i>(Evidenca 5.5 Kriete e pranimit)</i> <i>(Evidenca 1.3 Rregullorja e programit të studimit)</i> <i>(Evidenca 5.6 Guida e studentit)</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Institucioni ka treguar kujdes të veçantë për përfshirjen sociale, duke hartuar kritere specifike që lehtësojnë aksesin në studime për grupe të cënueshme. Për studentët me aftësi të kufizuara, ofrohen lehtësime procedurale dhe mbështetje praktike. Për pakicat dhe shtresat e marginalizuara, aplikohen kritere që balancojnë meritokracinë me ndjeshmërinë sociale. Ky angazhim dëshmon një filozofi të qartë gjithëpërfshirëse dhe është në përputhje me standardet evropiane të barazisë në arsim. <i>(Evidenca 5.7 Kuotat e parashikuara për studentet me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara)</i>

Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Për studentët e huaj, institucioni ka përgatitur udhëzime të veçanta që përfshijnë kërkesat për dokumentacionin akademik dhe administrativ, si dhe mënyrat e njohjes së diplomave të mëparshme. Këto kriteret janë të qarta, transparente dhe të publikuara në gjuhën angleze, duke lehtësuar aksesin për kandidatët ndërkombëtarë. Kjo politikë kontribuon në ndërkombëtarizimin e institucionit dhe në krijimin e një mjedisi akademik më të larmishëm. <i>(Evidenca 1.1 Statuti)</i> <i>(Evidenca 1.2 Rregullora Themelore e WBU)</i> <i>(Evidenca 5.2 Procedura e pranimit te studenteve te huaj)</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Institucioni ofron një gamë të bursave dhe lehtësimeve financiare që synojnë mbështetjen e studentëve në nevojë. Këto bursa janë të strukturuar në disa kategori: sociale, meritokracie dhe për programe me rëndësi strategjike për zhvillimin kombëtar. Politikat e tilla ndihmojnë në tërheqjen e studentëve cilësorë dhe në garantimin e aksesit për ata që përballen me vështirësi ekonomike. Ky është një element pozitiv që lidhet drejtpërdrejt me përgjegjësinë sociale dhe rolin zhvillimor të institucionit. <i>(Evidenca 5.10 Rregullorja e bursave mbi zbritjen e tarifës vjetore)</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - <i>Institucioni ka vendosur dhe zbaton politika të qarta, gjithëpërfshirëse dhe transparente që mbulojnë të gjithë ciklin akademik të studentëve.</i> - <i>Gjithashtu, politikat e bursave dhe mbështetjes financiare përbëjnë një element pozitiv që rrit aksesin dhe diversitetin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Institucioni ka vendosur një sistem të qartë dhe funksional për informimin e studentëve mbi kriteret e përparimit akademik. Rregullorja e studimeve dhe udhëzuesit përkatës përmbajnë hollësi mbi kushtet e kalimit nga një vit akademik në tjetrin, notën mesatare të kërkuar, detyrimet e krediteve, si dhe mekanizmat e mbështetjes në rast vështirësish. Informacioni është i aksesueshëm në faqen zyrtare të institucionit dhe shpërndahet rregullisht edhe përmes platformës elektronike të menaxhimit të studimeve. Kjo i jep studentëve siguri dhe parashikueshmëri në rrugëtimin e tyre akademik. <i>Rekomandohet që institucioni të punojë drejt përmirësimit të dizajnit dhe gjuhës së materialeve informuese, duke i bërë ato më të qarta dhe më miqësore për studentët, përfshirë edhe studentët ndërkombëtarë.</i> <i>Gjithashtu, sugjerohet krijimi i një mekanizmi të rregullt për matjen e kënaqësisë së studentëve mbi cilësinë e informacionit që marrin, gjë që do të ndihmonte në përshtatjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve.</i> <i>(Evidenca 1.1 Statuti)</i> <i>(Evidenca 1.2 Rregullorja Themelore e WBU)</i> <i>(Evidenca 1.3 Rregullorja programit të studimit)</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Procedurat për njohjen e kualifikimeve dhe studimeve të pjesshme janë të dokumentuara mirë dhe të publikuara qartë. Studentët kanë mundësi të marrin informacion të detajuar mbi procesin, dokumentacionin e nevojshëm dhe afatet përkatëse. Këto procedura respektojnë legjislacionin kombëtar dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, duke siguruar trajtim të drejtë dhe të njëjtë për të gjithë aplikantët. Një praktikë pozitive është se komisionet përkatëse e shoqërojnë procesin me komunikim të drejtpërdrejtë me studentët, duke sqaruar çdo paqartësi. <i>(Evidenca 5.12 Rregullore për njohjen dhe transferimin e studimeve)</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Rregullat e vlerësimit janë të qarta dhe të përcaktuara në programet mësimore (syllabus) të çdo lënde, të cilat u shpërndahen studentëve në fillim të semestrit. Përmes tyre sqarohet pesha e provimeve, detyrave, projekteve dhe aktiviteteve të tjera të vlerësimit. Institucioni përdor një kombinim të metodave tradicionale dhe moderne të vlerësimit, duke nxitur zhvillimin e aftësive praktike dhe kritike të studentëve. Studentët raportojnë transparencë të lartë në procesin e vlerësimit, pasi rezultatet publikohen në kohë dhe

	me akses elektronik. Kjo kontribuon në rritjen e besimit dhe përgjegjësisë së ndërsjellë. <i>(Evidenca 1.3 Rregullorja programit të studimit)</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Udhëzuesit për përgatitjen e diplomës dhe procedurat e diplomimit janë të detajuara dhe i dorëzohen studentëve në fillim të vitit akademik. Studentët informohen për formatin, kriteret e përzgjedhjes së temave, mënyrat e udhëheqjes nga pedagogët, si dhe afatet e dorëzimit. Gjithashtu, procedurat për mbrojtjen e diplomës janë transparente dhe të standardizuara. Kjo qartësi ndihmon studentët të planifikojnë në mënyrë të strukturuar fazën përfundimtare të studimeve. Praktikë pozitive është edhe mbështetja që u ofrohet studentëve nëpërmjet konsultimeve individuale dhe sesioneve të posaçme informuese. <i>(Evidenca 1.2 Rregullorja Themelore e WBU)</i> <i>(Evidenca 2.1 Rregullorja për programet e studimit të ciklit të parë dhe PI)</i> <i>(Evidenca 5.15 Manuali për provimin e diplomes)</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Institucioni ka zhvilluar një traditë pozitive në publikimin e udhëzuesve të posaçëm për studentët dhe në organizimin e ditëve të hapura. Në këto aktivitete, kandidatët dhe studentët e rinj marrin informacion mbi programin, kurrikulën, mundësitë e mobilitetit, bursat dhe perspektivat pas diplomimit. Gjithashtu, platforma online ofron broshura digjitale dhe materiale të tjera informuese. Ky kombinim i komunikimit të drejtpërdrejtë me atë online e bën informacionin lehtësisht të aksesueshëm dhe kontribuon në orientimin e duhur të studentëve të ardhshëm. <i>Sugjerohet krijimi i një mekanizmi të rregullt për matjen e kënaqësisë së studentëve mbi cilësinë e informacionit që marrin, gjë që do të ndihmonte në përshtatjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve.</i> <i>(Evidenca 5.16 Raport mbi veprimtarinë e Zyres së Komunimit, Marrëdhënieve me Publikun dhe Pranimin të studenteve))</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Institucioni ka zhvilluar një sistem të mirëstrukturuar informimi dhe transparence për studentët në çdo fazë të ciklit të studimeve.

	- Përdorimi i platformës elektronike, e cila shërben si një hapësirë e sigurt dhe praktike për publikimin e rezultateve dhe komunikimin me studentët. - Organizimi i ditëve të hapura dhe botimi i udhëzuesve informues çdo vit kontribuon në rritjen e besueshmërisë dhe afërsisë së institucionit me studentët dhe familjet e tyre. - Megjithatë, edhe pse informacioni i ofruar është i plotë dhe gjithëpërfshirës, ai mund të përmirësohet në aspektin e formës dhe qasjes. Disa materialë informues përdorin një gjuhë tepër teknike, që mund të rezultojë sfiduese për studentët e rinj ose për ata që nuk kanë përvojë të mjaftueshme me terminologjinë akademike. - Gjithashtu, nuk ka një mekanizëm të mirëfilltë matjeje për të vlerësuar nëse studentët janë të kënaqur me cilësinë dhe mënyrën se si u komunikohet informacioni. - Rekomandohet që institucioni të punojë drejt përmirësimit të dizajnit dhe gjuhës së materialeve informuese, duke i bërë ato më të qarta dhe më miqësore për studentët, përfshirë edhe studentët ndërkombëtarë. - Gjithashtu, sugjerohet krijimi i një mekanizmi të rregullt për matjen e kënaqësisë së studentëve mbi cilësinë e informacionit që marrin, gjë që do të ndihmonte në përshtatjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Institucioni siguron transparencë të lartë për strukturën dhe organizimin e programit të studimit. Në dokumentet rregullatore dhe udhëzuesit për studentët jepen të dhëna të detajuara mbi numrin e krediteve, ndarjen sipas viteve akademike dhe organizimin e praktikave profesionale. Kohëzgjatja e programit është në përputhje me kërkesat ligjore dhe komunikohet në mënyrë të qartë përmes faqes zyrtare të

	institucionit, broshurave të posaçme dhe gjatë aktiviteteve orientuese. Studentët konfirmojnë se informacioni është i qasshëm dhe i plotë, gjë që ndihmon në planifikimin personal dhe akademik. <i>(Evidenca 2.3 Kurrikula e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Teknik Imazherie")</i> <i>(Evidenca 1.3 Rregullorja e programit të studimit)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Për çdo lëndë/modul, institucioni harton syllabus-in përkatës, i cili përmban objektivat formues, rezultatet e të nxënit, temat, orët mësimore teorike dhe praktike, metodat e mësimdhënies dhe format e vlerësimit. Këta syllabus publikohen përpara fillimit të semestrit dhe janë lehtësisht të aksesueshëm në platformën elektronike. Kjo praktikë siguron që studentët të jenë të mirëinformuar për kërkesat akademike dhe të kenë mundësi të ndjekin progresin e tyre sipas standardeve të vendosura. <i>(Evidence 2.8 Syllabus model i një lënde)</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Përmes Zyrës së Karrierës, institucioni ofron informacion mbi mundësitë e punësimit, organizon takime me ish-studentë dhe aktorë të tregut të punës, si dhe aktivitete të tipit "career day". Ky informacion është i vlefshëm, por në disa raste mbetet në nivel të përgjithshëm dhe nuk është gjithmonë i personalizuar sipas profilit të programit. Megjithatë, angazhimi i institucionit për të forcuar këtë dimension është i dukshëm, duke përfshirë zhvillimin e partneriteteve me institucione dhe organizata të ndryshme. <i>(Evidenca 5.19 Praktika e nje rasti keshillimi karriere nga Zyra e Karrieres)</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Institucioni njofton në mënyrë të vazhdueshme studentët mbi oraret e mësimit, ndryshimet e mundshme, oraret e provimeve, si dhe mbi mundësitë që ofrojnë ambientet ndihmëse (biblioteka, laboratorë, sallat e IT-së, etj.). Ky informacion publikohet në sistemin elektronik, në njoftimet zyrtare dhe shpesh përforcohet përmes komunikimit direkt me koordinаторët e programeve. Studentët kanë akses në informacion të përditësuar, gjë që ndihmon në planifikimin e tyre akademik.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm	Institucioni ka në funksion një sistem elektronik të menaxhimit të informacionit (platformë online), i cili u siguron studentëve akses në orare, rezultate provimesh, syllabuse dhe dokumentacion tjetër. Platforma është funksionale, e përdorur gjerësisht nga studentët dhe shërben si një instrument thelbësor




të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	për informimin në kohë reale. Kjo rrit fleksibilitetin dhe përputhet me nevojat e mësimdhënies bashkëkohore, përfshirë studentët që ndjekin studimet në kushte pune apo në distancë.			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Institucioni demonstroi një angazhim të qartë dhe efektiv për të informuar studentët mbi të gjitha aspektet e programit të studimit, duke përfshirë strukturën, përmbajtjen, organizimin dhe mundësitë e punësimit. - Dokumentacioni zyrtar, syllabuset, udhëzuesit e posaçëm dhe platforma elektronike e menaxhimit të informacionit janë elementë që garantojnë transparencë dhe lehtësi në aksesim. - Gjithsesi, informacioni mbi mundësitë e punësimit mund të pasurohet më tej, duke qenë më i personalizuar sipas profilit të programit dhe nevojave specifike të tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni ka vendosur një sistem të qëndrueshëm për mbledhjen e statistikave vjetore, i cili mbulon të gjithë ciklin e studimeve për çdo program. Të dhënat përfshijnë regjistrimet e reja, numrin e studentëve që përfundojnë me sukses çdo vit akademik dhe të diplomuarve në fund të programit. Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë është Viti Akademik 2022-2023 - 13 studentë; Viti Akademik 2023-2024 - 27 studentë; Viti Akademik 2024-2025 - 15 studentë; Kjo ofron një panoramë të qartë mbi trendet e programeve dhe mundëson analizë të performancës së studentëve në kohë të caktuar. Sistemi i bën të mundur identifikimin e devijimeve dhe planifikimin e masave për përmirësim të vazhdueshëm.

GA

f8

	<i>(Evidenca 5.20 Lista e studenteve ne programin e studimit)</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Statistikat janë të detajuara dhe përfshijnë informacion mbi të gjithë studentët e regjistruar, duke pasqyruar tërheqjet, transferimet, si dhe rastet e mospërfundimit me sukses të vitit akademik. Kjo qasje i lejon institucioni të analizojë shkaqet e largimeve, të identifikojë faktorët që ndikojnë në suksesin e studentëve dhe të ndërmarë politika për rritjen e përqindjes së diplomimeve të suksesshme. Në këtë mënyrë, institucioni mund të marrë vendime të bazuara në të dhëna reale dhe të përmirësojë cilësinë e programeve. <i>(Evidenca 5.20 Lista e studenteve ne programin e studimit)</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Institucioni përdor një sistem elektronik të menaxhimit të informacionit, i cili garanton siguri të dhënash, kontroll të aksesit dhe auditim të të dhënave nga personat e autorizuar. Sistemi mundëson verifikimin e shpejtë të të dhënave, gjurmimin e ndryshimeve dhe ruajtjen e të dhënave historike. Kjo strukturë siguron besueshmëri dhe integritet të informacionit, duke ofruar bazë solide për raportime dhe analiza. <i>(Evidenca 3.31 Rregullorja e Zyres se Sekretarise Mesimore)</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njëjësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mesimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Kontrolli periodik i të dhënave është sistematik dhe i mbështetur me udhëzime dhe akte brenda institucionit. Njësitë përgjegjëse, si sekretaritë mesimore dhe stafi administrativ i platformës elektronike, kryejnë auditime të rregullta për të vlerësuar saktësinë, përditësimin dhe përpunueshmërinë e të dhënave. Çdo gabim apo mospërpunueshmëri dokumentohet dhe trajtohet me procedura të qarta korrigjuese. Kjo praktikë rrit besueshmërinë e të dhënave dhe kontribuon në një menaxhim profesional dhe të organizuar të informacionit mbi studentët. <i>(Evidenca 3.31 Rregullorja e Zyres se Sekretarise Mesimore)</i> <i>(Evidenca 4.41 Raporti i auditit te brendshem)</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në	Raportet analitike përgatiten rregullisht dhe përmbajnë informacion mbi profilin e studentëve, performancën akademike dhe treguesit e punësimit. Ato shoqërohen me rekomandime dhe masa për përmirësim të cilësisë së




hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	programeve, mbështetje gjatë studimeve dhe orientim drejt tregut të punës. Kjo praktikë mundëson një qasje të menaxhimit të bazuar në të dhëna dhe ndihmon institucionin në planifikimin strategjik dhe vendimmarrjen efektive. Raportet përdoren si mjet për monitorim dhe përmirësim të vazhdueshëm. <i>(Evidenca 3.31 Rregullorja e Zyres së Sekretarise Mesimore)</i> <i>(Evidenca 1.16 Raporti vjetor i Departamentit)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Institucioni ka vendosur një sistem të qëndrueshëm dhe të sigurt për mbledhjen, administrimin dhe analizimin e të dhënave mbi studentët gjatë gjithë ciklit të studimeve.</i> - <i>Statistikat e përgatitura ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi numrin e studentëve, suksesin akademik dhe mundësitë e punësimit, duke lejuar marrjen e vendimeve të bazuara mbi të dhëna të sakta.</i> - <i>Kontrolli periodik dhe auditimi i njësive përkatëse siguron që të dhënat të jenë të besueshme dhe të qëndrueshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Institucioni ka hartuar rregullore dhe akte interne që parashikojnë pjesëmarrjen e studentëve në këshillin e departamentit, komisionet për rishikimin e programeve dhe organet e tjera vendimmarrëse. Studentët dhe përfaqësuesit e tyre janë të përfshirë si anëtarë me të drejta të plota diskutimi dhe votimi, duke siguruar respektimin e ligjit dhe rregulloreve të brendshme. <i>(Evidenca 1.1 Rregullorja Themelore e WBU)</i>

	<i>(Evidenca 5.21 Perfshirja e studenteve ne Senatin Akademik)</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Përfshirja e studentëve është reale dhe e strukturuar, me pjesëmarrje aktive në mbledhje dhe komisione. Studentët kontribuojnë në vendimmarrje për programet e studimit dhe metodologjitë e mësimdhënies. Rezultatet e angazhimit janë të dokumentuara përmes procesverbaleve të mbledhjeve, raportimeve periodike dhe implementimit të sugjerimeve të tyre në rishikimet e programeve. <i>(Evidenca 5.21 Perfshirja e studenteve ne Senatin Akademik)</i> <i>(Evidenca 5.22 Pjesemarrja e studenteve ne organet kolegjiale)</i> <i>(Evidenca 5.23 Emerimi i studentit ne NjSBC)</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributit të tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Njësia akademike organizon takime të rregullta me studentët për shqyrtimin e programeve të studimit, duke përdorur pyetësorë, grupe fokusimi dhe diskutime në klasa. Kontributet e studentëve dokumentohen dhe shumë prej tyre reflektohen në ndryshimet e programeve. Kjo praktikë krijon një kulturë bashkëpunimi dhe përmirësim të vazhdueshëm të procesit mësimor. <i>(Evidenca 5.27 Praktike mbledhje me pjesemarrës përfaqësuesin e studenteve)</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Institucioni ka vendosur mekanizma të qartë për dhënien e feedback-ut nga studentët mbi procesin e vlerësimit, duke përfshirë procedura për ankime, rishikime të rezultateve dhe diskutime me pedagogët e përgjegjshëm. Studentët raportojnë një nivel të lartë transparence dhe mundësi reale për reflektim mbi procesin e vlerësimit, duke siguruar një mjedis të drejtë akademik. <i>(Evidenca 2.1 Rregullorja per programet e studimit te ciklit te pare dhe PI)</i>

Konkluzione	GVJ konstaton se: - Institucioni ka krijuar një kornizë të fortë për përfshirjen e studentëve në vendimmarrje dhe në rishikimin e programeve të studimit. - Pjesëmarrja e studentëve është e strukturuar, reale dhe e dokumentuar, duke kontribuar në vendimmarrje të bazuar në nevojat dhe pritshmëritë e tyre. - Procesi i përfshirjes së studentëve ka ndikim konkret në përmirësimin e programeve, metodave të mësimdhënies dhe shërbimeve ndaj studentëve. - Megjithatë, institucioni mund të pasurojë më tej këto praktika duke siguruar një monitorim të vazhdueshëm të efektivitetit të përfshirjes së studentëve dhe duke krijuar raporte periodike mbi ndikimin e drejtpërdrejtë të kontributeve të tyre në vendimmarrje.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Institucioni ka zhvilluar procedura të qarta dhe të dokumentuara që rregullojnë funksionimin e njësive të shërbimit për studentët. Këto procedura mbulojnë informimin, orientimin, menaxhimin e ankesave dhe trajtimin e problematikave të ndryshme. Njësitë funksionojnë sipas aktit rregullator të institucionit dhe janë të strukturuar për të garantuar qasje të lehtë dhe të drejtë për studentët. (Evidenca 1.11 Rregullorja mbi organizimin administrativ në WBU)
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për	Njësia përkatëse (p.sh. sekretariati mësimor dhe shërbimi për studentët) ofron këshillim dhe mbështetje të vazhdueshme për çështje akademike, duke ndjekur progresin e studentëve, duke ofruar informacione mbi lëndët, oraret dhe praktikat profesionale. Sistemi është funksional dhe i integruar me platformën elektronike të institucionit, duke lehtësuar ndjekjen

çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	individuale të studentëve dhe asistencën për problemet që mund të lindin gjatë studimeve. <i>(Evidenca 1.1 Statuti)</i> <i>(Evidenca 1.2 Rregullorja Themelore e WBU)</i> <i>(Evidenca 1.11 Rregullorja mbi organizimin administrativ ne WBU)</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e karrierës është aktive dhe ofron shërbime të vazhdueshme për studentët. Ajo organizon takime, seminare, dhe konsultime individuale mbi mundësitë e punësimit dhe praktikat profesionale. Studentët marrin udhëzime të detajuara për zgjedhjen e praktikave profesionale, përgatitjen e CV-së, si dhe për orientimin drejt tregut të punës. Kjo tregon një angazhim të lartë të institucionit për mbështetjen e zhvillimit profesional të studentëve. <i>(Evidenca 1.11 Rregullorja mbi organizimin administrativ ne WBU)</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Institucioni ka vendosur mekanizma për mbledhjen e informacionit mbi punësimin e studentëve pas diplomimit. Të dhënat përpunohen dhe ruhen në mënyrë të sigurt, dhe raportohet periodikisht tek organet drejtuese. Ky proces ndihmon në vlerësimin e efektivitetit të programeve, në identifikimin e nevojave të tregut dhe në orientimin e përmirësimeve të ardhshme. Megjithatë, ndonjëherë kërkohet përmirësim në pasqyrimin sistematik dhe vazhdimësinë e mbledhjes së të dhënave për të gjithë ish-studentët. <i>(Evidenca 1.11 Rregullorja mbi organizimin administrativ ne WBU)</i> <i>(Evidenca 1.13 Lista e studenteve perfitues te programit EPIC)</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Institucioni ka vendosur një strukturë të fortë për pritjen, orientimin dhe këshillimin e studentëve gjatë studimeve dhe pas diplomimit.

	- Shërbimi i karrierës është aktiv dhe ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët, duke i ndihmuar ata në zgjedhjen e praktikave dhe orientimin drejt tregut të punës. - Një pikë e fortë është funksionaliteti i platformës elektronike dhe lidhja me ndjekjen individuale të studentëve. - Një aspekt që mund të përmirësohet është rritja e vazhdueshme e sistemit për mbledhjen e të dhënave mbi punësimin e ish-studentëve dhe pasqyrimi më i plotë i të dhënave mbi suksesin e tyre në tregun e punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	WBU ka hartuar udhëzues dhe politika institucionale që promovojnë përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, në përputhje me fushën dhe lëndët e programeve të studimit. Personeli akademik dhe ndihmësakademik përdor një kombinim të leksioneve, laboratorëve, praktikave, vizitave studimore, seminareve dhe detyrave individuale për të siguruar arritjen e objektivave të programeve, duke respektuar larminë dhe nevojat e studentëve. Gjithashtu, institucioni mbështet zhvillimin e vazhdueshëm të kompetencave didaktike të personelit përmes trajnimeve të brendshme dhe bashkëpunimeve me akademikë vendorë dhe ndërkombëtarë, duke integruar teknologji moderne si Smartboard-et në auditorë, për të përmirësuar cilësinë dhe efektivitetin e procesit mësimor.

	<i>(Evidenca 1.2 Rregullorja Themelore e WBU)</i> <i>(Evidenca 1.3 Rregullorja e programit te studimit)</i> <i>(Evidenca 2.8 Syllabus model i një lënde)</i> <i>(Evidenca 3.1 Paketa e trajnimeve te organizuara per kurrikulen dhe mesimdhenien)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mesimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Institucioni ka vendosur mekanizma të qartë dhe funksionale për monitorimin dhe vlerësimin periodik të aftësive mesimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, kryen vlerësime të rregullta mbi performancën akademike dhe programet e studimit, duke dhënë rekomandime që ndiqen nga strukturat akademike dhe ndihmësakademike. <i>(Evidenca 3.5 Vendimi per ngritjen e Komisionit te Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë)</i> <i>(Evidenca 3.7 Vendimi per ngritjen e NjSBC)</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mesimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	WBU garanton përfshirjen aktive të studentëve në vlerësimin periodik të metodave dhe formave të mesimdhënies, si dhe të proceseve të vlerësimit të dijeve. Studentët marrin pjesë nëpërmjet pyetësorëve semestral në vlerësimin e performancës së personelit akademik dhe përmbajtjes së lëndëve. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion në takimin e zhvilluar me studentët e programit të studimit, u konfirmua se institucioni siguron mundësinë e trajtimit të ankimimeve të studentëve, sipas rregullave të përcaktuara në aktet institucionale. <i>(Evidenca 1.1 Statuti)</i> <i>(Evidenca 5.23 Përfshirja e studentit ne NjSBC)</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mesimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë dy strukturat kryesore në institucion, përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mesimdhënie. Rezultatet e vlerësimit të mesimdhënies publikohen rregullisht strukturat përgjegjëse në faqen web të institucionit, duke u bërë të aksesueshme për studentët, stafin akademik dhe të interesuarit e tjerë. Raportet e shoqëruara me rekomandime shërbejnë si bazë për hartimin e planeve të masave për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit.

	(Evidenca 3.6 Rregullorja e organizimit dhe funksionit te Komisionit te Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë) (Evidenca 3.8 Rregullorja e organizimit dhe funksionit te NjSBC) (Evidenca 6.5 Paketa e instrumenteve të cilësisë. Formular i vetëvlerësimit të stafit.)			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	WBU ka krijuar mekanizma të qartë për promovimin e praktikave të mira dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies nga personeli akademik. Përmes udhëzuesve institucionalë si “Guida e stafit”, politikave për promovim akademik, mbështetjes financiare për publikime dhe aktivitete kërkimore, si dhe programeve orientuese dhe trajnimeve, institucioni inkurajon zhvillimin profesional dhe shkëmbimin e praktikave të suksesshme. Këto iniciativa krijojnë një mjedis mbështetës dhe stimulues, duke nxitur cilësi të lartë në mësimdhënie dhe duke fuqizuar kontributin e personelit akademik në realizimin e objektivave të programeve të studimit. (Evidenca 6.5 Paketa e instrumenteve të cilësisë. Formular i vetëvlerësimit të stafit.)			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Institucioni ka krijuar një sistem të mirëorganizuar për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, duke përfshirë udhëzues institucionalë për metodat inovative, mekanizma monitorimi dhe vlerësimi periodik të personelit akademik dhe ndihmës akademik, si dhe përfshirjen aktive të studentëve në procesin e vlerësimit. - Rezultatet e vlerësimeve publikohen në mënyrë transparente dhe përdoren për promovimin e praktikave të mira dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. - Institucioni garanton gjithashtu mbështetje të qëndrueshme për zhvillimin profesional të stafit përmes trajnimeve, aktiviteteve orientuese dhe mbështetjes financiare për kërkimin shkencor dhe pjesëmarrjen në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Institucioni ka hartuar politika, ka ngritur struktura të dedikuara dhe ka përcaktuar procedura të qarta për vlerësimin periodik të performancës akademike, përfshirë vlerësimin e studentëve, personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ. Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit, në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë garanton monitorim të vazhdueshëm dhe përmirësim të procesit të cilësisë në institucion. <i>(Evidenca 3.6 Rregullorja e organizimit dhe funksionit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë)</i> <i>(Evidenca 3.8 Rregullorja e organizimit dhe funksionit të NjSBC)</i> <i>(Evidenca 6.5 Paketa e instrumenteve të cilësisë. Formular i vetëvlerësimit të stafit.)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Sistemi i Brendshëm për Sigurimin e Cilësisë në WBU zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, përfshirë një bashkëveprim të koordinuar midis Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë, Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, strukturave akademike dhe ndihmësakademike, studentëve, si dhe ekspertëve të jashtëm, duke garantuar përfshirjen aktive të të gjithë aktorëve të programit. Rezultatet e vlerësimeve bëhen publike, dhe rekomandimet e Nxjerra nga NjSBC shërbejnë si bazë për veprime të planifikuara dhe aktivitete të dedikuara për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, duke siguruar transparencë dhe rritje të cilësisë akademike. <i>(Evidenca 3.6 Rregullorja e organizimit dhe funksionit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë)</i> <i>(Evidenca 3.8 Rregullorja e organizimit dhe funksionit të NjSBC)</i>

	<i>(Evidenca 6.5 Paketa e instrumenteve të cilësisë. Formular i vetëvlerësimit të stafit.)</i> <i>(Evidenca 6.2 Formulari i vlerësimit të pedagogut)</i> <i>(Evidenca 3.4 Raporti i vlerësimit nga studentet për personelin akademik)</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, kanë hartuar dhe venë në zbatim përdorimin e një sërë instrumentesh dhe treguesish për sigurimin e cilësisë, duke përfshirë vlerësimet periodike të performancës akademike, kërkimit shkencor, infrastrukturës, burimeve njerëzore dhe aktiviteteve të tjera institucionale. Procesi përfshin raportimin e rezultateve të vlerësimeve nga NjSBC dhe nxjerrjen e rekomandimeve për përmirësimin e programeve të studimit, të cilat bëhen publike dhe shërbejnë si bazë për aktivitete të planifikuara të zhvillimit. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes akreditimeve, vlerësimeve analitike dhe krahasuese, si dhe mekanizmeve të tjerë si vlerësimet e studentëve, të diplomuarve dhe partnerëve nga industria e punës. <i>(Evidenca 6.5 Paketa e instrumenteve të cilësisë. Formular i vetëvlerësimit të stafit.)</i> <i>(Evidenca 6.2 Formulari i vlerësimit të pedagogut)</i> <i>(Evidenca 3.4 Raporti i vlerësimit nga studentet për personelin akademik)</i> <i>(Evidenca 6.3 Rast i planit të masave të ndërmara nga institucioni bazuar në raportet e vlerësimit të hartuara nga NjSBC)</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB si dhe takimit të zhvilluar në institucion me strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, konstatohet se institucioni ka ngritur një sistem të qartë dhe të matshëm për vlerësimin e performancës së personelit akademik, duke përdorur tregues të përcaktuar për mësimdhënie, kërkim shkencor, pjesëmarrje në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe vetëvlerësimin e personelit. Procesi përfshin pyetësorë për studentët, vlerësim nga kolegët dhe nga drejtuesit e departamenteve, me rezultate që dokumentohen dhe bëhen publike, duke siguruar transparencë. WBU mbështet zhvillimin profesional të stafit përmes trajnimeve, orientimeve dhe mundësive për pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. <i>(Evidenca 6.5 Paketa e instrumenteve të cilësisë)</i>

Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Institucioni ka krijuar politika dhe struktura të dedikuara, si dhe ka përcaktuar procedura të qarta për vlerësimin periodik të performancës akademike.</i> - <i>Procesi i sigurimit të cilësisë karakterizohet nga përfshirja aktive e të gjithë aktorëve të programit.</i> - <i>Institucioni mbështet zhvillimin profesional të stafit akademik përmes trajnimeve, aktiviteteve dhe pjesëmarrjes në projekte</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Institucioni kryen vlerësime të shumëfishta të programit dhe personelit akademik nga studentët aktualë, studentët e diplomuar/alumni, kolegët dhe drejtuesit e departamenteve, si dhe vetëvlerësim nga personeli akademik, të gjitha të integruara në paketën e instrumenteve të cilësisë. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe i bëhen të njohura autoriteteve drejtuese dhe vendimmarrëse të programit, duke mundësuar evidentimin e arritjeve dhe dobësive, promovimin e praktikave më të mira dhe hartimin e planeve konkrete për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit. Kjo qasje demonstroi një praktikë të qëndrueshme dhe sistematike të garantimit të cilësisë në WBU. <i>(Evidenca 6.5 Paketa e instrumenteve të cilësisë)</i> <i>(Evidenca 6.2 Formulari i vlerësimit të pedagogut)</i> <i>(Evidenca 3.4 Raporti i vlerësimit nga studentet për personelin akademik)</i> <i>(Evidenca 6.3 Rast i planit të masave të ndërmara nga institucioni bazuar në raportet e vlerësimit të hartuara nga NjSBC)</i>

Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Raportet e hartuara për vlerësimin e komponentëve të cilësisë përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet konkrete të vlerësimit, identifikimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, si dhe masat e ndërmarra për adresimin e dobësive dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. Raportet semestrale dhe vjetore të NjSBC dokumentojnë të dhënat për performancën e personelit akademik dhe studentëve, duke i bërë ato të njohura për autoritetet vendimmarrëse të programit. Ky proces siguron edhe motivimin e stafit akademik për arritje të larta në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, përmes promovimeve, mbështetjes për aktivitete shkencore dhe ngritjes në detyrë, si dhe motivimin e studentëve përmes bursave dhe stimuljeve të tjerë akademikë. <i>(Evidenca 6.2 Formulari i vlerësimit të pedagogut)</i> <i>(Evidenca 3.4 Raporti i vlerësimit nga studentet për personelin akademik)</i> <i>(Evidenca 6.3 Rast i planit të masave të ndërmarra nga institucionet bazuar në raportet e vlerësimit të hartuara nga NjSBC)</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, duke përfshirë vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, didaktikës, kurrikulës dhe të mësuarit, si dhe vlerësime paralele të provimeve dhe detyrave të studentëve, vëzhgime gjatë ushtrimeve praktike dhe testime lokale ose ndërkombëtare. Procesi i vlerësimit të pedagogëve nga studentët kryhet dy herë në vit, në mënyrë anonime dhe të dokumentuar përmes platformës SMART WBU, duke siguruar transparencë dhe integritet të të dhënave. Raportet përfundimtare u bëhen të ditura personelit akademik dhe autoriteteve vendimmarrëse, duke mundësuar identifikimin e dobësive dhe vendosjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. <i>(Evidenca 6.2 Formulari i vlerësimit të pedagogut)</i> <i>(Evidenca 3.4 Raporti i vlerësimit nga studentet për personelin akademik)</i> <i>(Evidenca 3.9 Lista e aktiviteteve trajnuese të realizuara sipas rekomandimeve të NjSBC)</i>

Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	WBU ka krijuar një sistem të mirëstrukturuar për vlerësimin e realizimit dhe cilësisë së programeve të studimit duke përdorur instrumente të tërthorta dhe të drejtpërdrejta. Metodatat e tërthorta përfshijnë sondazhe dhe intervista me studentët në prag të diplomimit, të diplomuarit (Alumni), personelin akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit dhe partnerët institucionalë. Rezultatet e këtyre vlerësimeve diskutohen në nivel departamenti dhe fakulteti, dhe përdoren për përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulës, metodave të mësimdhënies dhe përshtatjes së programit me nevojat e tregut të punës. Ndryshimet e propozuara miratohen nga Fakulteti dhe Senati Akademik dhe dokumentohen në dy gjuhë, duke garantuar transparencë, gjurmueshmëri dhe përdorim të efektshëm të informacionit për vendimmarrje të bazuar në të dhëna. <i>(Evidenca 6.2 Paketa e instrumenteve të cilësisë)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - Institucioni ka krijuar një sistem të mirëstrukturuar dhe të qëndrueshëm për vlerësimin e programeve dhe personelit akademik. - Rezultatet e vlerësimeve dokumentohen, diskutohen dhe i bëhen të njohura autoriteteve vendimmarrëse të programit, duke mundësuar evidentimin e dobësive dhe praktikave më të mira, promovimin e arritjeve, motivimin e stafit dhe studentëve, si dhe hartimin e planeve konkrete për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. - Mekanizmat e përdorur sigurojnë transparencë, integritet dhe gjurmueshmëri të të dhënave, duke garantuar vendimmarrje të bazuar në informacion, përmirësim të kurrikulave dhe metodave të mësimdhënies, dhe përshtatje të programeve me nevojat e tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	WBU përmes Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit (NjSBC), njësitë akademike, përfaqësuesve të studentëve dhe ekspertëve të jashtëm, garanton bashkëpunim dhe angazhim aktiv në vlerësimin e programeve. Politikat dhe procedurat e brendshme të institucionit janë të qarta dhe të dokumentuara, duke orientuar funksionimin e strukturave përgjegjëse dhe duke siguruar transparencë. Raportet e gjeneruara nga NjSBC janë të publikuara dhe të aksesueshme, duke kontribuar në mbarëvajtjen e procesit të sigurimit të cilësisë dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. <i>(Evidenca 3.6 Rregullorja e organizimit dhe funksionit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë)</i> <i>(Evidenca 3.8 Rregullorja e organizimit dhe funksionit të NjSBC)</i> <i>(Evidenca 3.4 Raporti i vlerësimit nga studentet për personelin akademik)</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Institucioni ka përcaktuar qartë përgjegjësi dhe detyra konkrete për të gjitha strukturat, individët dhe aktorët e përfshirë në sigurimin e brendshëm të cilësisë. Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë, në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), ka një mandat të qartë dhe të dokumentuar për hartimin e politikave, procedurave dhe për kryerjen e vlerësimeve periodike të performancës akademike, të studentëve dhe të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Përbërja e NjSBC-së, duke përfshirë përfaqësues të fakulteteve, studentë dhe ekspert të jashtëm, siguron një angazhim të balancuar dhe të përgjegjshëm të të gjitha palëve në procesin e sigurimit të cilësisë. <i>(Evidenca 3.6 Rregullorja e organizimit dhe funksionit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë)</i>

	<i>(Evidenca 3.8 Rregullorja e organizimit dhe funksionit te NjSBC)</i> <i>(Evidenca 4.16 Angazhimi i ekspertit te jashtem ne NjSBC)</i> <i>(Evidenca 6.11 Perfshirja e eksperteve te jashtem ne hartimin e programeve te reja)</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Institucioni garanton një përfshirje të gjerë dhe të strukturuar të të gjithë aktorëve në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë. Njësia bazë dhe njësia kryesore, personeli akademik dhe ndihmës-akademik, stafi administrativ dhe studentët janë të përfshirë në mënyrë aktive në të gjitha fazat e procesit, duke përdorur metoda të vetëvlerësimit, vlerësimit nga kolegët dhe nga studentët, si dhe vlerësime nga drejtuesit e departamenteve dhe Dekani. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në hartimin e kurrikulave dhe shqyrtimin e programeve, si dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në mbledhjet e njësive, siguron një proces gjithëpërfshirës dhe të balancuar. <i>(Evidenca 4.16 Angazhimi i ekspertit te jashtem ne NjSBC)</i> <i>(Evidenca 6.11 Perfshirja e eksperteve te jashtem ne hartimin e programeve te reja)</i> <i>(Evidenca 6.5 Paketa e instrumenteve te cilesise)</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Përfaqësimi i përbashkët i njësive kryesore, departamenteve, studentëve dhe ekspertëve të jashtëm në NjSBC, bashkë me përdorimin e pyetësorëve anonimë, shmang çdo formë diskriminimi apo pabarazie. Të dhënat e pyetësorëve përpunohen nga NjSBC dhe shpërndarja e informacioneve apo të dhënave mbi rezultatet, realizohet në mënyrë individuale, në zarf të mbyllur. <i>(Evidenca 4.16 Angazhimi i ekspertit te jashtem ne NjSBC)</i> <i>(Evidenca 6.11 Perfshirja e eksperteve te jashtem ne hartimin e programeve te reja)</i> <i>(Evidenca 6.5 Paketa e instrumenteve te cilesise)</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e	Nga të dhënat e raportuara si dhe vizita e zhvilluar në institucion, u konstatua se Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë përfshin përfaqësues nga njësitë kryesore, studentë dhe ekspertë të jashtëm, duke garantuar përfaqësimin e të gjithë aktorëve të interesit. Institucioni gjithashtu angazhon dhe kontraktton bashkëpunëtorë ose ekspertë të jashtëm me lidhje të drejtpërdrejta me programin e studimit, të cilët kontribuojnë në hartimin e kurrikulave, shqyrtimin e literaturës dhe propozimet për programe të reja.

mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	(Evidenca 6.17 Propozim për hapje të programeve të reja) (Evidenca 6.11 Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në hartimin e programeve të reja)			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Institucioni ka krijuar një sistem të strukturuar dhe transparent për sigurimin e cilësisë, ku politikat dhe procedurat janë të qarta dhe të dokumentuara, duke orientuar funksionimin e strukturave përgjegjëse dhe duke siguruar transparencë në të gjitha fazat e vlerësimit të programeve dhe personelit. - Procesi i sigurimit të cilësisë karakterizohet nga përfshirja e të gjithë aktorëve. - Institucioni siguron përdorimin e rezultateve të vlerësimeve për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe kurrikulave, duke përfshirë pjesëmarrjen e ekspertëve të jashtëm dhe bashkëpunëtorëve në hartimin e programeve dhe literaturës, si dhe duke garantuar përpunimin konfidencial të të dhënave dhe shpërndarjen e tyre në mënyrë të sigurt dhe të strukturuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë e WBU në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë transparente dhe të aksesueshme për studentët dhe të gjithë të interesuarit. Veprimtaria e institucionit udhëhiqet nga Plani Strategjik i Zhvillimit 2023-2030. Politikat dhe procedurat e sigurimit të cilësisë hartohen nga Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Raportet e vlerësimit publikohen dhe janë të lehta për t'u aksesuar në faqen zyrtare të universitetit, ndërsa rekomandimet e nxjerra pas përpunimit të të dhënave

	ndiqen nga strukturat akademike, ndihmës-akademike dhe administrative për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. <i>(Evidenca 1.6 Plani Strategjik i WBU 2023-2030)</i> <i>(Evidenca 3.6 Rregullorja e organizimit dhe funksionit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë)</i> <i>(Evidenca 3.8 Rregullorja e organizimit dhe funksionit të NjSBC)</i> <i>(Evidenca 3.4 Raporti i vlerësimit nga studentet për personelin akademik)</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Në faqen zyrtare të institucionit publikohen rezultatet e vlerësimeve të çdo programi studimi, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike pa shfaqur të dhëna personale të personelit të vlerësuar. Përpunimi i të dhënave bëhet në formën e raporteve të detajuara nga NjSBC, të cilat u bëhen me dijeni personelit dhe publikohet përkatësisht. Skedat individuale të vlerësimit të personelit akademik i komunikohet secilit në mënyrë konfidenciale, në zarf të mbyllur, pas përfundimit të sezonit të provimeve dhe shpalljes së rezultateve përfundimtare. <i>(Evidenca 3.4 Raporti i vlerësimit nga studentet për personelin akademik)</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raporti i hartuar nga NjSBC shoqërohet me rezultatet, sugjerimet dhe rekomandimet e studentëve. Në këtë kuadër, NjSBC, njësitë kryesore, njësitë bazë dhe strukturat drejtuese akademike dhe administrative identifikojnë arritjet dhe mangësitë dhe hartojnë plane veprimi për përmirësimin e tyre. Strukturat drejtuese organizojnë trajnime dhe aktivitete për zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies, duke promovuar shkëmbimin e eksperiencës mes stafit akademik. Personeli akademik dhe ndihmës-akademik është përfshirë në programe kualifikimi dhe trajnime të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor dhe përdorimin e teknikave inovative. <i>(Evidenca 3.4 Raporti i vlerësimit nga studentet për personelin akademik)</i> <i>(Evidenca 6.3 Rast i planit të masave të ndërmara nga institucioni bazuar në raportet e vlerësimit të hartuara nga NjSBC)</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron	WBU, në fillim të çdo viti akademik organizon ditë orientuese duke përfshirë takime dhe trajnime për kurrikulën dhe

efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	mësimdhënien, ku drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore, si dhe zyra të ndryshme, prezantojnë strukturën organizative të institucionit, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive, ecurinë e proceseve dhe objektivat e vitit akademik. <i>(Evidenca 3.11 Lista e plote dhe raporti i trajnimeve)</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) përfshin përfaqësues nga të gjitha njësitë kryesore, përfaqësues të studentëve dhe ekspertë të jashtëm, të cilët kontribuojnë me ekspertizë dhe mendime të vlefshme mbi cilësinë e programeve dhe mundësitë për përmirësim. Institucioni angazhon dhe kontraktton bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm për hartimin e kurrikulave, shqyrtimin e literaturës dhe propozimet për programe të reja studimi. Institucioni zhvillon pyetësorë për identifikimin e nevojave për trajnime të personelit, të cilat shërbejnë për hartimin e planeve vjetore të trajnimeve me ekspertë vendas dhe të huaj. Personeli i WBU-së ka mundësi për avancim profesional brenda dhe jashtë vendit, pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. <i>(Evidenca 4.16 Angazhimi i ekspertit të jashtëm në NJSBC)</i> <i>(Evidenca 5.23 Përfshirja e studentit në NJSBC)</i> <i>(Evidenca 6.8 Praktike e mbështetjes financiare për pjesëmarrje në konference)</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Institucioni ka krijuar një sistem të mirëorganizuar dhe transparent për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, duke përfshirë politika dhe procedura të qarta, mekanizma monitorimi dhe vlerësimi periodik të programeve dhe personelit akademik dhe ndihmës akademik, si dhe përfshirjen aktive të studentëve dhe ekspertëve të jashtëm në procesin e vlerësimit. - Rezultatet e vlerësimeve dhe rekomandimet për përmirësim publikohen dhe përdoren nga strukturat akademike dhe administrative për të promovuar praktikën e mirë dhe për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm të programeve të studimit dhe metodave të mësimdhënies. - Institucioni mbështet zhvillimin profesional të stafit përmes trajnimeve të vazhdueshme, aktiviteteve

76




	<i>orientuese dhe mundësive për pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknik Imazherie” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Western Balkan”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi ofron një përgatitje të gjerë në teknikat e imazherisë mjekësore, përfshirë metodat tradicionale dhe ato të avancuara.
2. Programi udhëhiqet nga profesorë me përvojë të gjerë, duke siguruar një mësimdhënie të cilësisë së lartë dhe një lidhje të ngushtë me praktikën më të fundit në fushën e imazherisë mjekësore.

Pika të dobta

- 1 Koordinimi dhe standardizimi i mentorimit dhe vlerësimit të studentëve nga partnerët e jashtëm nuk është i njëtrajtshëm, duke ndikuar në uniformitetin dhe cilësinë e përvojës praktike. **.(Standardi IV1, kriteri 7)**
 - Materialet informuese nuk janë gjithmonë të qarta dhe miqësore për studentët, veçanërisht për studentët ndërkombëtarë.
 - Nuk ekziston një mekanizëm i rregullt për matjen e kënaqësisë së studentëve mbi cilësinë e informacionit që marrin. **.(Standardi V2, kriteri 5)**

Rekomandime:

1. Përmirësimi i koordinimit dhe standardizimi i mentorimit dhe vlerësimit të studentëve nga partnerët e jashtëm për të rritur uniformitetin dhe cilësinë e përvojës praktike
2. Përmirësimi i dizajnit dhe gjuhës së materialeve informuese, duke i bërë ato më të qarta dhe më miqësore për studentët, përfshirë edhe studentët ndërkombëtarë.
3. Krijimi i një mekanizmi të rregullt për matjen e kënaqësisë së studentëve mbi cilësinë e informacionit që marrin, për të mundësuar përshtatjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Imaging Technician" provided by the Higher Education Institution, University of Western Balkans, Tirana

Strengths and affirmations

1 .The program offers comprehensive training in medical imaging techniques, including both traditional and advanced methods.

The program is led by professors with extensive experience, ensuring high-quality teaching and a close connection with the latest practices in the field of medical imaging.

Weaknesses

- 1.The coordination and standardization of student mentoring and assessment by external partners are not consistent, affecting the uniformity and quality of the practical experience.
- 2.Informational materials are not always clear and student-friendly, particularly for international students.
- 3There is no regular mechanism for measuring student satisfaction regarding the quality of the information they receive.

Recommendation

1. Improve the coordination and standardization of student mentoring and assessment by external partners to enhance the uniformity and quality of the practical experience.
2. Improve the design and language of informational materials, making them clearer and more student-friendly, including for international students.
3. Establish a regular mechanism for measuring student satisfaction regarding the quality of the information they receive, to enable continuous adaptation and improvement of services.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X


